Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Albanian Microfinance Association



Raporti Vjetor

2025

RAPORTI VJETOR 2025

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive — 04
2025 në shifra dhe gjetjet kryesore

01 Dy fjalë nga Presidenti — 08
Reflektime mbi një vit zhvillimi, transformimi dhe qëndrueshmërie për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri.

02 Rreth Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare — 10
Një organizatë jo-fitimprurëse që përfaqëson, promovon dhe mbështet institucionet e mikrofinancës në Shqipëri.

03 Sektori i mikrofinancës dhe zhvillimet e tij — 13
Prioritetet strategjike dhe fushat kryesore të veprimtarisë së institucioneve financiare jobanka gjatë vitit 2025.

04 Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit — 16
Aktivet e SHKK-ve u rritën me 13.1% në 18.33 miliardë lekë, ndërsa rezultati financiar arriti në 233 milionë lekë.

05 Institucionet anëtare të Shoqatës — 19
Portofoli aktiv arriti në 53.6 miliardë lekë, kreditë e reja në 44.3 miliardë lekë dhe NPL zbriti në 6.2%.

06 Portofoli, klientët dhe ndikimi — 23
304,706 kredi të disbursuara dhe 178,679 klientë aktivë: një sektor i pjekur dhe gjithëpërfshirës.

07 Veprimtaria e Shoqatës dhe prioritetet strategjike — 28
Një përpjekje kolektive për të rritur vizibilitetin dhe ndikimin e mikrofinancës në ekonominë kombëtare.

08 Profilet e institucioneve anëtare — 30
Aktivitetet, arritjet dhe prioritetet e anëtarëve

Agro & Social Fund SHA 32
Crimson Finance Fund Albania 36
FED invest SHKK 38
Fondi Besa 40
iute Albania 42
ECFA sha · Kredo.al 46
MiA Finance 50
UniFin SHKK 54

09 Përmbledhje e aktiviteteve të Shoqatës gjatë vitit 2025 — 56
Dialog institucional, financim i gjelbër, transformim digjital dhe përfaqësim ndërkombëtar.

Shkurtesat — 60
Shtojcë

VITI NË NJË VËSHTRIM

2025 në shifra

53.6

mld lekë
portofol aktiv i institucioneve anëtare

44.3

mld lekë
kredi të reja gjatë vitit

6.2%

kredi me probleme (NPL), niveli më i ulët i viteve të fundit

37

subjekte financiare jobanka
në fund të vitit 2025

78 mld

lekë aktive të IFJB-ve
nga 75.12 mld në 2024

304,706

kredi të disbursuara
gjatë vitit 2025

178,679

klientë aktivë
në fund të vitit 2025

45%

e klientëve aktivë janë gra
80,137 gra (2025)

31%

e klientëve në zona rurale
krahasuar me 69% urbane

Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare; Banka e Shqipërisë. Të gjitha shifrat janë marrë nga kapitujt e këtij raporti.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2025

Ky raport paraqet zhvillimet e sektorit të mikrofinancës në Shqipëri gjatë vitit 2025, performancën e institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare dhe veprimtarinë e Shoqatës. Gjetjet kryesore më poshtë janë përmbledhur drejtpërdrejt nga të dhënat e kapitujve të raportit.

78 mld

lekë aktive të IFJB-ve

Sektori jobankar përfshin 37 subjekte. Aktivet u rritën rreth 3.8% në vit dhe rreth 34.5% që nga viti 2022.

SHIH KAPITULLIN 03

53.6 mld

lekë portofol aktiv i anëtarëve

Nga 49 miliardë lekë në 2024. Kreditë e reja arritën 44.3 miliardë lekë, ndërsa NPL zbriti në 6.20%.

SHIH KAPITULLIN 05

+24%

portofoli i kredisë për individë

Individët 22.1 mld lekë; bizneset 24.49 mld lekë (+4.5%); bujqësia 7.10 mld lekë (−1.8%).

SHIH KAPITULLIN 05

304,706

kredi të disbursuara në 2025

178,679 klientë aktivë në fund të vitit; 45% e tyre gra dhe 31% në zona rurale.

SHIH KAPITULLIN 06

+13.1%

rritje e aktiveve të SHKK-ve

Aktivet 18.33 mld lekë, portofoli bruto 14.3 mld lekë, rezultati financiar 233.17 milionë lekë (ROE 11%).

SHIH KAPITULLIN 04

2025

një vit dialogu dhe bashkëpunimi

Shoqata u angazhua në dialog rregullator, financim të gjelbër, pagesa digjitale, siguri kibernetike dhe përfaqësim ndërkombëtar.

SHIH KAPITULLIN 09



“Mikrofinanca nuk përfaqëson vetëm akses në financë, por një instrument zhvillimi ekonomik dhe përfshirjeje sociale për mijëra familje dhe sipërmarrje shqiptare.”

Dy fjalë nga Presidenti

Reflektime mbi një vit zhvillimi, transformimi dhe qëndrueshmërie për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri.

01

Dy fjalë nga Presidenti

“Viti 2025 përfaqësoi një tjetër etapë zhvillimi dhe transformimi për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri.”

ARLINDA MUJA, PRESIDENT

Të nderuar anëtarë të shoqatës, partnerë të dashur, përfaqësues të institucioneve publike dhe private, miq të sektorit të mikrofinancës,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin të ndaj me ju disa reflektime në emër të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, në përmbyllje të një viti tjetër të rëndësishëm për sektorin tonë dhe për shoqërinë në tërësi. Viti 2025 përfaqësoi një tjetër etapë zhvillimi dhe transformimi për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri. Në një mjedis ekonomik dhe rregullator gjithnjë e më dinamik, institucionet e mikrofinancës vijuan të luajnë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e aksesit financiar, mbështetjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e komuniteteve lokale në të gjithë vendin.

Gjatë këtij viti, sektori demonstroi qëndrueshmëri dhe kapacitet përshtatës përballë sfidave të tregut, duke ruajtur ritmet e zhvillimit të portofolit dhe duke investuar më tej në digjitalizim, menaxhim risku dhe përmirësim të eksperiencës së klientit. Mikrofinanca vazhdon të mbetet një instrument kyç për financimin e individëve, fermerëve dhe bizneseve të vogla që mbeten të nënshërbyera nga sistemi tradicional bankar.

“Mikrofinanca nuk përfaqëson vetëm akses në financë, por një instrument zhvillimi ekonomik dhe përfshirjeje sociale për mijëra familje dhe sipërmarrje shqiptare.”

Një fokus i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë forcimi i standardeve të qeverisjes, transparencës dhe përputhshmërisë rregullatore. Ndryshimet në kuadrin mbikëqyrës dhe rritja e kërkesave për kontroll operacional dhe siguri kibernetike kanë kërkuar angazhim të shtuar nga institucionet anëtare dhe investime të vazhdueshme në teknologji dhe kapacitete njerëzore.

Një tjetër prioritet strategjik mbetet përfshirja financiare dhe mbështetja e zhvillimit rural. Institucionet anëtare kanë vijuar të zgjerojnë praninë e tyre në zonat rurale dhe gjysmë urbane, duke mbështetur fermerët, gratë sipërmarrëse dhe bizneset familjare përmes produkteve financiare të përshtatura me nevojat e tyre.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka vijuar të luajë një rol aktiv në përfaqësimin e interesave të sektorit, në dialogun institucional me autoritetet publike dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe në promovimin e praktikave më të mira të mikrofinancës. Përmes aktiviteteve, trajnimeve dhe bashkëpunimeve strategjike, Shoqata ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në rritjen e vizibilitetit të sektorit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Po ashtu, Shoqata ka organizuar një sërë aktivitetesh informuese dhe trajnimesh për anëtarët, ka ndjekur me përkushtim zhvillimet ndërkombëtare në fushën e mikrofinancës dhe ka vijuar të promovojë standarde të larta etike dhe profesionale.

Ndërkohë, transformimi digjital dhe integrimi i praktikave ESG po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të ardhmen e sektorit. Investimet në teknologji, automatizim, mbrojtje të të dhënave dhe zhvillim të qëndrueshëm do të mbeten prioritete kryesore edhe gjatë viteve në vijim.

Në emër të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, dëshiroj të falenderoj të gjithë anëtarët, partnerët dhe bashkëpunëtorët për angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë këtij viti. Bashkëpunimi dhe profesionalizmi juaj mbeten themeli i zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të mikrofinancës në Shqipëri.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare do të vijojë të promovojë një sektor mikrofinanciar modern, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Ju falenderoj të gjithëve për mbështetjen dhe besimin, dhe ju ftoj të vijojmë së bashku në misionin tonë për një mikrofinancë më gjithëpërfshirëse, më të fortë dhe më të drejtë për të gjithë.

Me respekt të veçantë,

Arlinda Muja

PRESIDENT · SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE

02

Rreth Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

Një organizatë jo-fitimprurëse që përfaqëson, promovon dhe mbështet institucionet e mikrofinancës në Shqipëri.

“Misioni i Shoqatës është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të sektorit të mikrofinancës në Shqipëri.”

02

Rreth Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

9

institucione anëtare aktive në vitin 2025

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar me synimin për të përfaqësuar, promovuar dhe mbështetur institucionet e mikrofinancës në Shqipëri. E krijuar si një urë bashkëpunimi mes aktorëve të sektorit dhe institucioneve publike, AMA synon të forcojë rolin e mikrofinancës si një mjet zhvillimi ekonomik dhe përfshirjeje sociale, duke garantuar standarde të larta profesionale dhe etike në industrinë e mikrofinancës.

Nëpërmjet aktiviteteve të saj, AMA përfaqëson interesat e anëtarëve përballë institucioneve rregullatore dhe vendimmarrëse, promovon zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale, dhe nxit bashkëpunimin me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznes për institucionet financiare jo-banka që operojnë në Shqipëri.

Misioni dhe Vizioni

Misioni i Shoqatës është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të sektorit të mikrofinancës në Shqipëri, duke fuqizuar rolin e institucioneve të anëtarësuara në përfshirjen financiare, mbështetjen e bizneseve të vogla dhe zhvillimin e zonave rurale.

Vizioni i Shoqatës është një treg financiar gjithëpërfshirës, etik dhe i qasshëm për të gjithë individët dhe sipërmarrësit shqiptarë, ku mikrofinanca është e integruar si një komponent i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Vlerat dhe Parimet Udhëheqëse

Shoqata udhëhiqet nga një grup vlerash thelbësore që përbëjnë bazën e funksionimit të saj dhe të anëtarëve:

VLERAT

Vlerat dhe parimet udhëheqëse

01

Transparenca dhe Etika

Veprimtari të bazuara në integritet dhe në respektimin e standardeve më të larta të etikës profesionale.

02

Përgjegjësia Sociale

Kontribut i qëndrueshëm në përmirësimin e jetës së komuniteteve dhe grupeve të pambrojtura, veçanërisht në zonat rurale.

03

Përfshirja Financiare

Zgjerimi i aksesit në shërbime financiare për individë dhe biznese që nuk përfshihen nga sektori tradicional bankar.

04

Zhvillimi i qëndrueshëm

Mbështetje për praktikat që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor afatgjatë.

05

Partneriteti dhe Bashkëpunimi

Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me institucionet publike, rregullatore, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat.

STRUKTURA

Struktura organizative e Shoqatës

NIVELI 1

Asambleja e Anëtarëve

Që është organi më i lartë vendimmarrës

NIVELI 2

Presidenti

I cili drejton Asamblenë e Anëtarëve në vendimmarjen strategjike për zhvillimin e Shoqatës

NIVELI 3

Sekretariati Ekzekutiv

I cili drejton aktivitetin e përditshëm dhe implementon politikat e miratuara nga Asambleja dhe Presidenti

NIVELI 4

Komitete të përhershme dhe të përkohshme

Të cilat trajtojnë çështje të veçanta teknike, ligjore apo zhvillimore sipas nevojës së sektorit

Struktura Organizative

Struktura organizative e Shoqatës përbëhet nga:

Anëtarët e Shoqatës në vitin 2025

Në fund të vitit 2025, Shoqata përfaqëson një grup të larmishëm institucionesh financiare jo-banka, që operojnë në fusha të ndryshme të kreditimit, mikrokredisë, pagesave dhe shërbimeve financiare digjitale. Anëtarët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të sektorit mikrofinanciar shqiptar për sa i përket portofolit të kredisë, shtrirjes gjeografike dhe ndikimit ekonomik-social.

Anëtarët aktivë për vitin 2025 përfshijnë:

- Agro & Social Fund
- Crimson Finance Fund Albania
- Fondi BESA
- Fed Invest SHKK
- ECFA
- Iute Albania
- MIA Finance
- NOA[1]
- UNIFIN SHKK

[1] NOA u bashkua zyrtarisht me ABI Bank me datë efektive 27 nëntor 2025.

Disa nga këto institucione janë certifikuar nga Komisioni Europian për përputhshmëri me Kodin e Sjelljes dhe Praktikave të Mira për Mikrokredinë në Evropë, duke treguar angazhimin e tyre për praktika të mira dhe mbrojtje të klientit.

Partneritetet dhe Bashkëpunimet Strategjike

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka zhvilluar një rrjet të gjerë partneritetesh strategjike, si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, me synimin për të rritur kapacitetin e sektorit dhe për të ndikuar pozitivisht në mjedisin ligjor, rregullator dhe zhvillimor të mikrofinancës në Shqipëri.

Partnerët kryesorë përfshijnë:

- **Institucionet publike shqiptare**, si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Investimeve, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), etj.
- **Donatorë ndërkombëtarë dhe organizata zhvillimi**, si Banka Botërore, IFC, GIZ, BERZH, etj.
- **Rrjete dhe shoqata**, përfshirë përkatësinë në European Microfinance Network (EMN) dhe Microfinance Centre (MFC).
- **Institucione arsimore dhe kërkimore**, për të promovuar edukimin financiar dhe hulumtimin në fushën e mikrofinancës.

02

Rreth Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

"Një rrjet i gjerë partneritetesh strategjike, brenda vendit dhe në nivel ndërkombëtar."


78

mld lekë

aktive totale të IFJB-ve në 2025

Sektori i mikrofinancës dhe zhvillimet e tij

Prioritetet strategjike dhe fushat kryesore të veprimtarisë së institucioneve financiare jobanka gjatë vitit 2025.



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare. Vlerat në miliardë lekë.

Veprimtaria e Institucioneve Financiare Jo-Banka

Në fund të vitit 2025, sistemi financiar shqiptar përfshin 37 subjekte financiare jobanka,nga te cilat 22 subjekte janë institucione të kredisë, mikrokredisë, faktoringut, qirasë financiare pa hyrje të reja në treg, por me një proces të vazhdueshëm përforcimi të standardeve të licencimit dhe kontrollit. Ky proces pasqyron një riorganizim të tregut, me një fokus të shtuar në qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Në këtë kontekst, aktiviteti i SFJB-ve shtrihet në një gamë të gjerë shërbimesh financiare, duke përfshirë kreditimin në forma tradicionale dhe alternative, mikrokreditë, qiratë financiare, faktoringun dhe shërbimet këshilluese dhe ndërmjetëse. Kjo diversifikim shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për mbështetjen e segmenteve të ndryshme të ekonomisë, veçanërisht atyre që nuk janë plotësisht të përfshirë nga sistemi bankar tradicional.

Aktualisht, në tregun financiar operojnë **37 IFJB**, nga të cilat 22 subjekte janë institucione të kredisë, mikrokredisë, faktoringut, qirasë financiare, blerjes së kredive me probleme etj., 4 subjekte janë institucione pagesash dhe 11 janë institucione të parasë elektronike.

Aktiviteti kryesor i IFJB-ve është ai kreditues (32%), ndjekur nga shërbimet këshilluese (20%), ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve (17%), si dhe qiraja financiare (15%). Në sistemin financiar operojnë gjithashtu 15 SHKK dhe një union, 13 shoqëri sigurimi, 15 fonde investimi dhe 7 fonde pensioni.

Aktiviteti Kreditues i SFJB-ve


Gjatë vitit 2025, institucionet financiare jobanka (IFJB) vijuan të konsolidojnë pozicionin e tyre në tregun financiar shqiptar, duke regjistruar një rritje të mëtejshme të aktiveve totale. Siç paraqitet në grafik, totali i aktiveve arriti në 78 miliardë lekë, nga 75.12 miliardë lekë në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 3.8% në baza vjetore.

Në një horizont katërvjeçar, aktivet e sektorit janë rritur nga 58 miliardë lekë në vitin 2022 në 78 miliardë lekë në vitin 2025, ose me rreth 34.5%, duke reflektuar zgjerimin e vazhdueshëm të aktivitetit të institucioneve financiare jobanka, rritjen e portofolit të financimeve dhe forcimin e rolit të tyre në financimin e individëve dhe bizneseve.

Ky trend pozitiv dëshmon stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit, si edhe besimin në rritje të klientëve ndaj institucioneve financiare jobanka, të cilat vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e përfshirjes financiare dhe zhvillimit ekonomik në vend.

GRAFIK 01

Totali i aktiveve të IFJB-ve



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Në fund të vitit 2025, portofoli total i kredisë i institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare arriti në 53.7 miliardë lekë, duke reflektuar një zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues dhe një rol të rëndësishëm të sektorit në financimin e ekonomisë. Struktura e portofolit tregon një shpërndarje të konsoliduar ndërmjet institucioneve anëtare, ku pjesën më të madhe e zënë Fondi Besa, NOA dhe Iute Albania, të cilat së bashku përfaqësojnë mbi dy të tretat e portofolit total.

03

Sektori i mikrofinancës dhe zhvillimet e tij

37

subjekte financiare jobanka në fund të vitit 2025

+34.5%

rritje e aktiveve të sektorit, 2022–2025

03


Sektori i mikrofinancës dhe zhvillimet e tij

6.20%

raporti i kredive me probleme, nga 6.28% në 2024

GRAFIK 02

Teprica e kredisë për IFJB-të, bruto dhe neto



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

GRAFIK 03

Portofoli sipas tipologjisë së financimit

Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Burimet e Financimit dhe Sfidat për Mundësimin e Tyre

Subjektet financiare jobanka vijojnë ta mbështesin aktivitetin e tyre kryesisht në kapitalin e vet dhe financimin përmes huamarrjeve, duke ruajtur një strukturë financimi që ka mundësuar zgjerimin e aktivitetit kreditues gjatë vitit 2025. Burimet e financimit sigurohen si nga institucionet financiare vendase, ashtu edhe nga partnerë dhe institucione financiare ndërkombëtare, duke mbështetur rritjen e portofolit të kredisë dhe investimet në produkte të reja financiare. Megjithatë, sektori mbetet i ekspozuar ndaj kostos së financimit dhe zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare.

Pavarësisht performancës pozitive të sektorit, sigurimi i fondeve afatgjata dhe me kosto konkurruese mbetet një nga sfidat kryesore për institucionet financiare jobanka. Rritja e normave të interesit në vitet e fundit, pasiguritë në tregjet financiare dhe kufizimet në aksesin ndaj instrumenteve alternative të financimit ndikojnë në aftësinë e institucioneve për të zgjeruar aktivitetin kreditues me ritme të larta dhe për të diversifikuar më tej produktet e tyre.

Raporti i Stabilitetit Financiar vlerëson se sektori jobankar mbetet i mirëkapitalizuar, ndërsa për institucionet kredituese cilësia e portofolit të kredisë vijon të jetë e mirë. Megjithatë, forcimi i burimeve të financimit afatgjatë, zgjerimi i mundësive për financim institucional dhe zhvillimi i instrumenteve të reja financiare mbeten prioritete për të mbështetur rritjen e qëndrueshme të sektorit në vitet në vijim.

Cilësia e Portofolit të Kredisë dhe Performanca Financiare

Gjatë vitit 2025, institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare vijuan të ruajnë një cilësi të mirë të portofolit të kredisë, ndërkohë që aktiviteti kreditues u zgjerua dhe portofoli aktiv arriti në 53.6 miliardë lekë, nga 49 miliardë lekë në vitin 2024. Paralelisht, edhe vëllimi i kredive të reja u rrit në 44.3 miliardë lekë, duke reflektuar rritjen e kërkesës për financim dhe zgjerimin e aktivitetit të institucioneve anëtare.

Pavarësisht rritjes së portofolit, cilësia e tij vijoi të përmirësohej. Raporti i kredive me probleme zbriti në 6.20% në fund të vitit 2025, krahasuar me 6.28% në vitin 2024, duke vijuar trendin rënës të viteve të fundit. Ky zhvillim pasqyron përmirësimin e proceseve të vlerësimit të riskut, monitorimit të kredive dhe menaxhimit të portofolit nga institucionet anëtare.

Në tërësi, kombinimi i rritjes së portofolit aktiv me uljen e raportit të kredive me probleme konfirmon qëndrueshmërinë e sektorit dhe aftësinë e institucioneve financiare jobanka për të zgjeruar aktivitetin kreditues duke ruajtur standarde të mira të menaxhimit të riskut dhe cilësisë së aktiveve.

04

Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit

Aktivet e SHKK-ve u rritën me 13.1% në 18.33 miliardë lekë, ndërsa rezultati financiar arriti në 233 milionë lekë.

18.33
mld lekë
aktive totale, +13.1%

14.3
mld lekë
portofol bruto kredie, +9.2%

233.17
mln lekë
rezultati financiar

04
Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit

14 + 1
SHKK dhe union në fund të vitit 2025

11%
ROE — kthimi mesatar nga kapitali, nga 8% në 2024

1.35%
ROA — kthimi mesatar nga aktivet, nga 1% në 2024

Numri i Shoqërive

Gjatë vitit 2025, numri i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) ka pësuar ndryshime si rezultat i konsolidimit të mëtejshëm të sektorit. Në fund të vitit numërohen 14 SHKK dhe 1 union, nga të cilat 9 SHKK janë të përfshira në skemën e sigurimit të depozitave. Unioni Shqiptar Kursim-Kredi (USHKK) vijon të jetë i licencuar, por nuk ushtron aktivitet.

Ecuria e Aktiveve

Aktivet totale të SHKK-ve arritën në 18.33 miliardë lekë në fund të vitit 2025, nga 16.21 miliardë lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar një rritje vjetore prej 13.1%. Rritja është mbështetur kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit të SHKK-ve më të mëdha. Struktura e aktiveve mbetet e orientuar kryesisht drejt huadhënies ndaj anëtarëve (75%), ndërsa 22% përfaqësohet nga mjete likuide.

Pavarësisht rritjes së qëndrueshme, SHKK-të vijojnë të përfaqësojnë një pjesë relativisht të vogël të sistemit financiar, me aktive sa rreth 0.8% e aktiveve të sistemit bankar. Megjithatë, ritmi i rritjes dhe orientimi i aktivitetit drejt kreditimit të anëtarëve konfirmojnë rolin e tyre në zgjerimin e aksesit në financim.


Zhvillimet në Portofolin e Kredisë

Portofoli bruto i kredisë së SHKK-ve arriti në rreth 14.3 miliardë lekë në dhjetor 2025, nga 13.06 miliardë lekë një vit më parë, duke regjistruar një rritje vjetore prej 9.2%. Kredia neto arriti në 13.70 miliardë lekë, ndërsa portofoli bruto i SHKK-ve përfaqëson rreth 1.51% të portofolit të kredisë së sistemit bankar.

Në aspektin e cilësisë së portofolit, raporti i kredive me probleme ishte 5.1% në fund të vitit 2025, me një rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Kjo sugjeron se zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar me një përkeqësim të lehtë të cilësisë së portofolit, ndaj ky tregues duhet monitoruar krahas ritmeve të rritjes.

GRAFIK 04

Aktivet dhe portofoli i kredisë së SHKK-ve



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare. Seritë e grafikut origjinal ishin të emërtuara "Kredite bruto/neto"; vlerat përputhen me aktivet dhe portofolin e përshkruar në tekst.

Treguesi i kredive me probleme për SHKK-të arriti në 5.1% në fund të vitit 2025, duke shënuar një rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Pavarësisht kësaj rritjeje modeste, cilësia e portofolit mbetet përgjithësisht e qëndrueshme, në kushtet e zgjerimit të aktivitetit kreditues. Ecuria e këtij treguesi kërkon vijimin e monitorimit të kujdesshëm të cilësisë së kredisë dhe forcimin e praktikave të administrimit të rrezikut, veçanërisht në kushtet e rritjes së portofolit.

Rezultati Financiar i SHKK-ve

Rezultati financiar i SHKK-ve gjatë vitit 2025 shënoi një përmirësim të ndjeshëm, duke arritur në 233.17 milionë lekë, nga 160.6 milionë lekë në vitin 2024. Kjo ecuri pozitive është ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i shpenzimeve për provigjionet e kredisë dhe shpenzimeve të veprimtarisë, si dhe nga rritja e të ardhurave neto nga interesi. Përmirësimi i performancës reflektohet edhe në treguesit e rentabilitetit: kthimi mesatar nga aktivet (ROA) u rrit në 1.35%, nga 1% në vitin 2024, ndërsa kthimi mesatar nga kapitali (ROE) arriti në 11%, nga 8% një vit më parë.

Në tërësi, sektori i SHKK-ve vijoi të zgjerojë aktivitetin gjatë vitit 2025, duke ruajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve financiare, veçanërisht për individët dhe komunitetet me akses më të kufizuar në

sistemin bankar tradicional. Rritja e aktiveve dhe e portofolit të kredisë dëshmon vijimin e aktivitetit dhe zgjerimin e ndërmjetësimit financiar të sektorit. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i mëtejshëm kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj cilësisë së portofolit, kapitalizimit, administrimit të rrezikut dhe eficiencës operacionale.

Për të avancuar në mënyrë të qëndrueshme, këto institucione synohet fokus i mëtejshëm si më poshtë:

- Zhvillimin e strategjive të forta të menaxhimit të riskut për të minimizuar rritje potenciale në kreditë me probleme.
- Rritjen e kapitalizimit dhe forcimin e kapitalit për të përballuar presionet financiare.
- Inovacionin në produktet financiare dhe përdorimin e teknologjive të reja për të zgjeruar aksesin dhe përmirësuar shërbimet ndaj anëtarëve.
- Diversifikimin e burimeve të financimit për të reduktuar varësinë nga depozitat dhe për të mundësuar rritjen e kreditimit në kushte të qëndrueshme.

Këto hapa janë thelbësorë për të rritur potencialin e SHKK-ve dhe unionit financiar për të mbështetur më mirë ekonominë mikro dhe sektorët që janë më të ndjeshëm ndaj mungesës së financimit.

04

Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit


53.6

mld lekë

portofol aktiv i institucioneve anëtare

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

Portofoli aktiv arriti në 53.6 miliardë lekë, kreditë e reja në 44.3 miliardë lekë dhe NPL zbriti në 6.2%.



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare. Vlerat në miliardë lekë.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në planet e veta synon përfshirjen e të gjithë institucioneve financiare jo-banka që e gjejnë veten në aktivitetin, prioritetet dhe misionin e saj.

Gjatë vitit 2025, institucionet anëtare të Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës kanë vijuar të konsolidojnë pozicionin e tyre në tregun financiar, duke reflektuar një performancë të qëndrueshme dhe progresive në drejtim të financimit të ekonomisë, mbështetjes së individëve dhe bizneseve të vogla, si dhe nxitjes së zhvillimit rural.

Gjithashtu gjate vitit 2025, institucionet anetare kane rritur fokusin e tyre ne finacimin e gjelber, duke mbeshtetur investimet ne eficencen e energjise, energjine e rinovueshme dhe zgjidhjet e qendrueshme per familjet dhe biznesin e vogel e agrar.

Treguesit kryesorë financiarë tregojnë një rritje të kontrolluar të veprimtarisë kreditore, një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së portofolit dhe një kapacitet të lartë për të përballuar sfidat e ambientit rregullator dhe ekonomik.

Zhvillimet në portofolin e kredisë dhe kreditë e reja

Gjatë vitit 2025, institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare vijuan të ruajnë një cilësi të mirë të portofolit të kredisë, ndërkohë që aktiviteti kreditues u zgjerua dhe portofoli aktiv arriti në 53.6 miliardë lekë, nga 49 miliardë lekë në vitin 2024. Paralelisht, edhe vëllimi i kredive të reja u rrit në 44.3 miliardë lekë, duke reflektuar rritjen e kërkesës për financim dhe zgjerimin e aktivitetit të institucioneve anëtare.

Pavarësisht rritjes së portofolit, cilësia e tij vijoi të përmirësohej. Raporti i kredive me probleme zbriti në 6.20% në fund të vitit 2025, krahasuar me 6.28% në vitin 2024, duke vijuar trendin rënës të viteve të fundit. Ky zhvillim pasqyron përmirësimin e proceseve të vlerësimit të riskut, monitorimit të kredive dhe menaxhimit të portofolit nga institucionet anëtare.


05
Institucionet anëtare të Shoqatës

—

44.3 mld
lekë kredi të reja gjatë vitit 2025

GRAFIK 05

Portofoli aktiv, kredia e re dhe treguesi i kredive me probleme



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Në tërësi, kombinimi i rritjes së portofolit aktiv me uljen e raportit të kredive me probleme konfirmon qëndrueshmërinë e sektorit dhe aftësinë e institucioneve financiare jobanka për të zgjeruar aktivitetin kreditues duke ruajtur standarde të mira të menaxhimit të riskut dhe cilësisë së aktiveve

05
Institucionet anëtare të Shoqatës

—

24.49 mld
lekë portofol kredie për biznese

+24%
rritje e portofolit të kredisë për individë

Segmentimi i tregut dhe përformanca sipas kategorive kryesore

Kredia për biznese


Gjatë vitit 2025, portofoli i kredisë për biznese vijoi të zgjerohet, duke arritur në 24.49 miliardë lekë, nga 23.42 miliardë lekë një vit më parë, ose me një rritje prej rreth 4.5%. Rritja e portofolit tregon vazhdimësinë e mbështetjes që institucionet financiare jobanka u ofrojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe bizneseve familjare, të cilat mbeten segmenti kryesor i klientelës së sektorit.

Paralelisht, numri i kredive aktive për biznese vijoi të ulet, duke zbritur në 21,945 kredi, krahasuar me 27,901 në vitin 2024. Ky zhvillim sugjeron një rritje të vlerës mesatare të kredisë së disbursuar dhe një orientim më të madh drejt financimit të bizneseve me nevoja më të larta për kapital, ndërkohë që institucionet vijojnë të ruajnë fleksibilitetin dhe shpejtësinë në ofrimin e produkteve financiare.

Në tërësi, ecuria e këtij segmenti pasqyron konsolidimin e aktivitetit kreditues për bizneset, me një portofol në rritje dhe një fokus në financime me vlerë më të lartë, duke mbështetur zhvillimin e sipërmarrjes dhe aktivitetit ekonomik në vend.


GRAFIK 06

Kredia për biznes: teprica dhe numri i kredive aktive



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kredia për bujqësinë: teprica dhe numri i kredive aktive



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kredia për bujqësinë


Gjatë vitit 2025, portofoli i kredisë për bujqësinë mbeti relativisht i qëndrueshëm, duke arritur në 7.10 miliardë lekë, me një rënie të lehtë prej rreth 1.8% krahasuar me vitin 2024. Ndërkohë, numri i kredive aktive vijoi të bjerë, duke zbritur në 7,057 kredi nga 8,659 një vit më parë.

Ky zhvillim reflekton jo vetëm një konsolidim të portofolit, por edhe tendencën e reduktimit të numrit të fermave dhe bizneseve të vogla bujqësore aktive, si pasojë e fragmentimit të tokës, emigracionit dhe sfidave ekonomike me të cilat përballet sektori.

Në këtë kontekst, institucionet financiare jobanka kanë vijuar të mbështesin sektorin me financime me vlerë më të lartë për klientët ekzistues dhe investime më të konsoliduara, duke ruajtur një rol të rëndësishëm në financimin e bujqësisë.

GRAFIK 08

Kredia për individë: teprica dhe numri i kredive aktive



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kredia për individë

Gjatë vitit 2025, portofoli i kredisë për individë vijoi trendin rritës, duke arritur në 22.1 miliardë lekë, nga 17.8 miliardë lekë në vitin 2024, ose rreth 24% më shumë. Kjo rritje tregon zgjerimin e financimit për individët dhe rritjen e vlerës së portofolit të këtij segmenti.

Nga ana tjetër, numri i kredive aktive shënoi një rënie të lehtë, duke zbritur nga 143,219 kredi në vitin 2024 në 132,258 kredi në fund të vitit 2025. Ky zhvillim sugjeron një konsolidim të portofolit, ku institucionet financiare jobanka kanë orientuar financimin drejt kredive me vlerë mesatare më të lartë, duke ruajtur një ritëm të qëndrueshëm të kreditimit dhe një menaxhim më efikas të portofolit.


Në tërësi, ecuria e këtij segmenti tregon se, pavarësisht rënies së numrit të kredive aktive, kërkesa për financim individual mbetet e fortë, ndërsa vlera e portofolit vazhdon të rritet, duke reflektuar rritjen e madhësisë mesatare të kredive dhe një fokus më të madh në financimin e nevojave afatgjata të individëve.

Struktura e financimit dhe kapaciteti institucional

Anëtarët e Shoqatës vijojnë të mbështesin veprimtarinë me burime të sigurta financimi, si kapitali vetjak dhe huamarrjet nga institucione financiare partnere. Megjithë këtë, mungesa e aksesit në skema sovrane ose garanci shtetërore, si ato që i ofrohen sektorit bankar, vepron si pengesë për zbutjen e kostove dhe zgjerimin e aksesit në segmente me risk të lartë.

GRAFIK 09

Burimet e financimit të veprimtarisë së anëtarëve




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

304,706

kredi të disbursuara

Institucionet anëtare të shoqatës mikrofinanca Shqiptare



45%

45% e klientëve aktivë janë gra

Çdo pikë = 1% e klientëve aktivë në 2025. Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare.


Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në planet e veta synon përfshirjen e të gjithë institucioneve financiare jo-banka që e gjejnë veten në aktivitetin, prioritetet dhe misionin e saj.

Portofoli aktiv i institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare ka vijuar trendin pozitiv të rritjes edhe gjatë vitit 2025, duke arritur në rreth 53.6 miliardë lekë, nga 49.1 miliardë lekë një vit më parë. Në të njëjtën kohë, volumi i kredive të disbursuara u rrit në rreth 44.3 miliardë lekë, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit kreditues dhe rritjen e kërkesës për financim. Paralelisht me zgjerimin e portofolit, cilësia e tij është përmirësuar më tej, pasi treguesi i kredive me probleme (NPL) ka rënë në 6.2%, niveli më i ulët i viteve të fundit.

178,679
klientë aktivë në fund të vitit 2025

GRAFIK 10

Portofoli aktiv, volumi i disbursuar dhe NPL, 2018–2025



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Këta tregues dëshmojnë për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të mikrofinancës, të mbështetur në politika të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut, rritje të aktivitetit kreditues dhe një administrim më efikas të portofolit.

Struktura e portofolit të financimeve të institucioneve anëtare të Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës gjatë vitit 2025 paraqet një diversifikim të qartë të aktivitetit kreditues, në përputhje me modelin e biznesit dhe segmentet e tregut që secila institucion synon të mbulojë.

Në nivel sektori, kreditë për biznes përbëjnë peshën më të madhe të portofolit, duke reflektuar rolin e rëndësishëm të mikrofinancës në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sipërmarrësve dhe vetëpunësimit. Njëkohësisht, kreditë individuale zënë një pjesë të konsiderueshme të portofolit, duke kontribuar në përmirësimin e aksesit në financë për familjet dhe individët, ndërsa kreditë bujqësore vijojnë të mbeten një komponent i rëndësishëm për institucionet që operojnë në zonat rurale dhe mbështesin zhvillimin e sektorit agro.

Ky diversifikim i portofolit dëshmon fleksibilitetin e sektorit të mikrofinancës për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të klientëve dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës, duke mbështetur individët, bizneset dhe aktivitetet bujqësore në të gjithë vendin.


Struktura e portofolit të institucioneve anëtare të Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës paraqet profile të ndryshme financimi, duke reflektuar strategjitë dhe segmentet e tregut ku secila prej tyre operon. Institucionet si IuteCredit, ECFA dhe Unifin kanë një fokus të theksuar në kreditimin e individëve, ndërsa Besa Fund, Crimson Finance Fund dhe Agros Social Fund dominohen nga kreditimi i bizneseve dhe sektorit bujqësor. Nga ana tjetër, FedInvest shfaq një portofol më të balancuar, me peshë të konsiderueshme të financimeve për bizneset dhe bujqësinë, në përputhje me misionin e saj për mbështetjen e zonave rurale dhe zhvillimin e sektorit agro.

06
Portofoli, klientët dhe ndikimi

45%
e klientëve aktivë janë gra (2025)

GRAFIK 11

Përqendrimi i portofolit sipas llojit të kredisë, 2025




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Ky diversifikim i portofolit tregon se sektori i mikrofinancës ofron një gamë të gjerë produktesh financiare, duke iu përgjigjur nevojave të individëve, sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si edhe aktivitetit bujqësor. Specializimi i institucioneve në segmente të ndryshme kontribuon në një mbulim më të gjerë të tregut dhe forcon rolin e sektorit në promovimin e përfshirjes financiare dhe zhvillimit ekonomik në vend.

GRAFIK 12


Volumi i disbursimeve sipas sektorit, në nivel anëtari



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

GRAFIK 13

Sektorët e ekonomisë të mbështetur nga IFJB-të




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare. Përqindjet janë sipas grafikut origjinal (shuma 92%).

Grafiku më poshtë paraqet ecurinë e numrit të kredive të disbursuara dhe të klientëve aktivë të institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare gjatë periudhës 2019–2025. Pas tkurrjes së aktivitetit në vitin 2020, sektori shënoi një rikuperim të qëndrueshëm në vitet pasuese, duke arritur në 304,706 kredi të disbursuara në vitin 2025, nivel që mbetet ndër më të lartët e periudhës së analizuar. Ndërkohë, numri i klientëve aktivë u stabilizua në 178,679 klientë në fund të vitit 2025, pas nivelit maksimal prej 199,588 klientësh të regjistruar në vitin 2023.

GRAFIK 14

Kreditë e disbursuara dhe klientët aktivë, 2019–2025




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Këto zhvillime tregojnë se institucionet anëtare kanë ruajtur një nivel të lartë të aktivitetit kreditues, duke konsoliduar marrëdhëniet me klientët ekzistues dhe duke rritur efikasitetin në përdorimin e portofolit. Stabilizimi i numrit të klientëve, i shoqëruar me një volum të lartë kredidhënieje, reflekton pjekurinë e sektorit dhe aftësinë e tij për t'iu përgjigjur në mënyrë të qëndrueshme nevojave për financim të individëve dhe bizneseve.

GRAFIK 15


Kredia mesatare e dhënë sipas llojit



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

GRAFIK 16

Klientët aktivë sipas gjinisë



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Gratë vijojnë të përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të klientëve të financuar nga sektori i mikrofinancës.

Kjo dëshmon rolin e sektorit në rritjen e përfshirjes financiare dhe aksesin në financim për gratë në Shqipëri.

Sektori i mikrofinancës vijon të luajë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e përfshirjes financiare në të gjithë vendin. Edhe pse pjesa më e madhe e klientëve është e përqendruar në zonat urbane, financimi në zonat rurale mbetet i konsiderueshëm, duke reflektuar rolin e mikrofinancës në ofrimin e aksesit në financim edhe për komunitetet më pak të shërbyera.

Vihet re një rritje e konsiderueshme e financimit të gjinisë femërore në vend pothuaj me 40% me shumë se vitet e tjera, e cila dëshmon për mbështetjen gjinore në sektorin e mikrofinancës si pasojë e mbështetjes dhe edukimit financiar të vazhdueshëm.


06
Portofoli, klientët dhe ndikimi

31%

e klientëve aktivë në zona rurale (2025)

GRAFIK 17

Klientët aktivë sipas zonës



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

TABELA 01

Impakti ekonomik nga punësimi, sipas institucionit anëtar

INSTITUCIONI	DEGË	STAFI	OFICERË KRED.	STAFI (GRAFIK)
Agro & Social Fund	14	94	49	
Fondi Besa	77	629	358	
Crimson Finance Fund	1	16	6	
FED invest	59	316	117	
Kredo Finance	38	220	156	
NOA	28	343	116	
UniFin	20	49	27	
iute Credit	12	121	35	
MiA Finance	12	76	22	

Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Tendencat strategjike dhe dixhitalizimi

Institucionet anëtare kanë investuar ndjeshëm në dixhitalizimin e proceseve të kreditimit, vlerësimit të riskut dhe shërbimit ndaj klientit. Kjo ka sjellë ulje të kohës së përpunimit të aplikimeve, rritje të efikasitetit dhe ndërtim të besimit me klientët. Për me tepër, pjesa dërrmuese e institucioneve kanë filluar të integrojnë kritere ESG në strategjitë e tyre operacionale.

Përfundim

Viti 2025 paraqet një vit progresi të qëndrueshëm për sektorin e mikrofinancës, duke reflektuar kapacitetin e lartë të institucioneve anëtare për të ruajtur balancën midis zgjerimit të portofolit dhe menaxhimit efektiv të riskut. Ritja e moderuar, cilësia e portofolit, orientimi drejt bujqësisë dhe individëve, si dhe investimi në dixhitalizim përforcojnë rolin e mikrofinancës si aktor kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës mbetet e angazhuar në mbrojtjen e interesave të sektorit dhe në nxitjen e politikave që sigurojnë qasje të barabartë, qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë në jetën e qytetarëve dhe në zhvillimin e ekonomisë vendase.

07

Veprimtaria e Shoqatës dhe prioritetet strategjike

07

Veprimtaria e Shoqatës dhe prioritetet strategjike

"Mbështet konsolidimin teknik dhe institucional të anëtarëve të saj."

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare operon në kontekstin specifik ekonomik me objektivin përfundimtar për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të ardhshëm të vendit, dhe në veçanti për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen financiare të individëve të vetëpunësuar, fermerëve, sipërmarrësve të vegjël dhe NVM-ve, përmes forcimit të sektorit të mikrofinancave dhe institucioneve që veprojnë në të .

Veprimtaria e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare është pjesë e një përpjekje kolektive dhe të përbashkët midis institucioneve të saj anëtare, për të rritur vizibilitetin institucional në ndikimin që ka mikrofinanca në ekonominë kombëtare. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka një rol të ndjeshëm në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës që rregullon veprimtarinë e mikrofinancës në Shqipëri, duke promovuar praktikat më të mira, duke ndarë njohuritë dhe duke prezantuar instrumente të reja financiare midis anëtarëve të saj dhe publikut të gjerë. Mbështet konsolidimin teknik dhe institucional të anëtarëve të saj, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe duke identifikuar trendet financiare dhe ekonomike

Viti 2024 ka qenë një vit me angazhime të rëndësishme nga ana e shoqatës dhe anëtarëve të saj. Gjatë këtij viti u konsolidua më tej pozicioni i Shoqatës si një aktor i rëndësishëm në nismat dhe zhvillimet që i takojnë tregjeve financiare. Nëpërmjet bashkëpunimeve të vendosura dhe ndërveprimit institucional, Shoqata koordinoi veprimtaritë për të rritur nivelin profesional të qeverisjes korporative, aftësive institucionale për të përmirësuar klimën e sektorit financiar, nivelin e edukimit dhe përfshirjes financiare, standartet e larta të aftësive teknologjikë që ofrojnë shërbim të shpejtë dhe me cilësi, duke ndikuar në eksperiencën e klientit, etj.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Albanian Microfinance Association

AGROKREDIT

ASF INSTITUCION FINANCIAR

CFF Crimson Finance Fund

FED invest

FONDI BESA INSTITUCION FINANCIAR

iute

Kredo.al

MiA finance Microcredit Institution Albania

NOA INSTITUCION FINANCIAR

UniFin SHOQËRI KURSIM KREDITI

Agro & Social Fund SHA

“Për të tretin vit radhazi, ASF-së iu akordua çmimi për kontributin në fushatën Borrow Wisely.”

Agro Social Fund SHA ka operuar për afro një dekadë nën emrin dhe logon Agro & Social Fund sh.p.k., periudhë gjatë së cilës ka shënuar zhvillime të rëndësishme, si rritja e ndjeshme e portofolit të kredisë, zgjerimi i produkteve dhe shtrirja gjeografike në zona rurale dhe urbane. Këto zhvillime, së bashku me procesin e transformimit të formës ligjore, krijuan nevojën për rishikimin e identitetit vizual dhe pozicionimit në treg.

Në këtë kuadër, institucioni ndërmori procesin e ribrandimit, duke u identifikuar me emrin tregtar ASF dhe një identitet të ri vizual, më bashkëkohor dhe përfaqësues.

Ribrandimi u shtri pothuajse në të gjitha degët, duke përfshirë përmirësimin e elementeve fizike dhe promovuese, si dhe brandimin e automjeteve, me qëllim forcimin e prezencës dhe unifikimin e imazhit institucional.

Paralelisht, gjatë periudhës shtator–nëntor 2025, u realizua menaxhimi i rrjeteve sociale përmes shërbimit outsourcing, i shoqëruar me një fushatë marketingu të dedikuar, e cila kontribuoi në rritjen e dukshmërisë dixhitale dhe në forcimin e perceptimit të ASF-së si një institucion modern, profesional dhe i besueshëm.



Fushata “Huamarrje e zgjuar” dhe nisma



“Mikrofinanca për sipërmarrësit në moshën 50–64 vjeç”.

Gjatë muajit Tetor 2025, ASF zhvilloi fushatën sensibilizuese për një huamarrje të zgjuar #Borrow Wisely. Kjo fushatë nisi paraprakisht me trajnimin e stafit të degëve, për të mundësuar aftësimin e tyre për shpërndarjen e mesazheve, koncepteve dhe detajeve shpjeguese. Në të njëjtën kohë në rrjetet sociale të ASF-së u publikuan me postime të njëpasnjëshme të gjitha elementet e një huamarrje të zgjuar, të cilat i ndihmojnë individët të kuptojnë hap pas hapi se cfarë të kërkojnë në mënyrë që të jenë të mirëinformuar para se të marrin një kredi.

Në muajin Nëntor 2025, ASF iu bashkua fushatës “Mikrofinanca për Sipërmarresit në Moshën 50-64 vjeç”, një nismë që synon të forcojë rolin e mikrofinancës në mbështetjen e sipërmarrësve në moshë të rritur dhe të nxisë një ekosistem më gjithëpërfshirës për bizneset e vogla. Sipas raportit të OECD “The Missing Entrepreneurs”, mbi 5 milionë persona të moshës 50–64 vjeç në BE mungojnë në sipërmarrje – një potencial i madh i pashfrytëzuar për zhvillimin ekonomik.

Aktivitete

Pjesëmarrja në aktivitete të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit ka qenë një tjetër fokus i rëndësishëm institucional, duke shërbyer si një mënyrë efektive për rritjen e vizibilitetit, shkëmbimin e njohurive dhe ndërtimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Në datat 27-29 Maj 2025 ASF mori pjesë në edicionin e 27-të i Konferencës Vjetore të MFC, tematika e së cilës ishte “Shifts, Shocks and Solutions: Microfinance in the Shadow of Geopolitics”.Gjatë ditëve në këtë Konferencë, përfaqësuesit e ASF-së zhvilluan takime në mbeshtetje apo zgjerim të network-ut të partnerëve me Triple Jump, Enabling Qapital, , Inpulse, Frankfurt School-Financial Services, ResponsAbility dhe MCE Social Capital, Grameen Credit Agricole, Blue Orchard etj, si dhe u ndoqën takime në të cilat u diskutuan tema me rëndësi strategjike për sektorin. Gjithashtu, në këtë konferencë për të tretin vit rradhazi, ASF-së ju akordua cmimi për kontributin saj në fushatën Borrow Wisely 2024!





Konferenca Vjetore e MFC, maj 2025.

Gjatë datave 15–17 Tetor 2025, ASF mori pjesë në Konferencën Vjetore të European Microfinance Network (EMN), e zhvilluar në Cagliari, Itali, e cila këtë vit u fokusua në temën “Roadmap to Sustainability and Inclusive Development: Microfinance as a Catalyst for Building Stronger Local Communities”. Ky aktivitet mblodhi institucione mikrofinanciare, organizata zhvillimi dhe partnerë europianë, duke krijuar një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e praktikave më të mira, ideve dhe qasjeve inovative mbi rolin e mikrofinancës në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirjes financiare dhe inovacionit social. Pjesëmarrja e ASF-së në këtë konferencë theksoi angazhimin e institucionit për këto prioritete strategjike, ndërsa përfaqësuesit tanë patën mundësinë të ndajnë përvojën e tyre në fushën e mikrofinancës, të diskutojnë sfidat aktuale të sektorit dhe të forcojnë bashkëpunimin me institucione evropiane.





Konferenca Vjetore e EMN, Cagliari, tetor 2025.

Gjatë vitit 2025, stafi drejtues dhe specialistë të ASF-së morën pjesë në një total prej 20 programe trajnimi, certifikime profesionale dhe webinarë me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e kulturës së riskut, sigurisë dhe përputhshmërisë ligjore, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave personale, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe transformimin dixhital.

Paralelisht, gjatë vitit u realizuan edhe trajnime orientimi nga departamentet e ASF-së për stafin e ri të punësuar, me qëllim integrimin e tyre në strukturat dhe proceset e punës së institucionit.

NË VIJIM, CERTIFIKIMET PROFESIONALE DHE TRAJNIMET TEMATIKE TË NDJEKURA GJATË VITIT 2025:

CERTIFIKIME PROFESIONALE

Gjatë vitit u ndoqën programe certifikuese, përfshirë:

1. programi “Certified Expert in Risk Management”, i organizuar nga Frankfurt School of Finance & Management, me fokus në analizën moderne të riskut të kredisë, tregut, likuiditetit dhe riskut operacional;
2. certifikimin për CompTIA Security+, i organizuar nga Tirana ICT Academy dhe i orientuar drejt sigurisë kibernetike, menaxhimit të kërcënimeve, monitorimit dhe reagimit ndaj incidenteve;
3. trajnim profesional për certifikim si Ekspertë Fiskalë, i organizuar nga Instituti i Ekspertëve Fiskalë, me fokus kontabilitet, legjislacion dhe system tatimor, analizë e pasqyrave financiare dhe e drejta tregare ;
4. trajnimin profesional për certifikim si “Nënpunës për mbrojtjen e të dhënave personale”, i organizuar nga Kolegji Universitar i Biznesit i njohur nga Zyra e Komisionerit për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

TRAJNIME TEMATIKE

Stafi mori pjesë gjithashtu në trajnime njëditore dhe webinarë, me tematika që përfshinë:

- sigurinë kibernetike, menaxhimin e incidenteve dhe reziliencën digjitale;
- parandalimin e mashtrimit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe identitetin digjital;
- mbrojtjen e të dhënave personale dhe masat organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë;
- zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe transformimin dixhital (ERP & EPM).

Këto aktivitete u organizuan nga institucione si AKSK, AIF, IFC, Instituti i Ekspertëve Fiskalë, Kolegji Universitar i Biznesit, Kolegji Europian, UNICEF, MFC & Sifta Team, Prisma sh.p.k. Tirana ICT Academy, si dhe institucione të arsimit të lartë.

SHTRIRJA E TRAJNIMEVE SIPAS NIVELEVE ORGANIZATIVE:

- Stafi manaxherial mori pjesë në trajnime strategjike dhe programe certifikuese në fushat e menaxhimit të riskut, kapitalit njerëzor, mbrojtjen e të dhënave personale, AML/CFT dhe transformimit dixhital.
- Stafi specialist (IT, Risk, Financë) u angazhua në trajnime teknike dhe tematike, kryesisht në sigurinë kibernetike dhe raportimin financiar.
- Stafi në degë dhe stafi i ri përfitoi nga trajnime dhe orientime të brendshme të realizuara nga departamentet përkatëse, me fokus njohjen me politikat, procedurat dhe proceset e punës së institucionit.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, trajnimet e ndjekura kontribuuan në rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit në të gjitha nivelet, përmirësimin e sigurisë dhe përputhshmërisë rregullatore, si dhe në forcimin e qëndrueshmërisë operacionale dhe institucionale të ASF-së.

Fokusi dhe prioritetet për vitin 2026

Në vitin 2026, fokusi i Politika lidhur me Marketingun do të jetë orientuar drejt forcimit të markës së re të institucionit, promovimit të produkteve ekzistuese dhe zhvillimit të produkteve të reja financiare, si dhe rritjes së prezencës së ASF-së në treg përmes aktiviteteve të strukturuara të komunikimit dhe studimit të tregut.

Gjatë këtij viti pritet të rritet ndjeshëm angazhimi dhe ekspozimi ndaj klientëve në media dhe rrjete sociale, duke krijuar bazën për zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit të institucionit në platformat digjitale dhe përmirësimin e ndërveprimit me publikun.

Objektivat kryesore gjatë vitit 2026 do të jenë:

- Konsolidimin e logos dhe identitetit të ri vizual, duke përfshirë të gjithë komponentët e saj dhe finalizimin e të gjitha përditësimeve të nevojshme në materialet promovuese dhe informative të institucionit;
- Monitorimin e vazhdueshëm të tregut, përmes analizës së trendeve dhe ndryshimeve eventuale, me qëllim përshtatjen në kohë të produkteve dhe shërbimeve me kërkesat reale të klientëve;
- Rishikimin e performancës së produkteve ekzistuese, duke vlerësuar ecurinë e tyre, nivelin e përputhshmërisë me nevojat e klientëve dhe mundësinë e modifikimit ose zhvillimit të produkteve të reja, kur kjo rezulton e nevojshme;
- Pjesëmarrjen aktive në aktivitete profesionale, si konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, tryeza të rrumbullakëta dhe takime të organizuara nga Shoqata e Mikrofinancës, organizatat partnere vendase dhe ndërkombëtare;
- Promovimin e ASF-së pranë grupeve të ndryshme të interesit, duke synuar prezantimin e qartë të vlerave, produkteve dhe avantazheve konkurruese ndaj klientëve potencialë;
- Hartimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese, si fletëpalosjet me kushtet dhe termat e kredive, duke garantuar nivel të lartë transparence mbi produktet financiare të ofruara;
- Forcimin dhe mirëmenaxhimin e komunikimit me Degët e ASF-së, për adresimin dhe koordinimin e çdo çështjeje që lidhet me fushat e Marketingut, Zhvillimit dhe Trajnimit;
- Rritjen e arritshmërisë dhe angazhimit në rrjetet sociale dhe mediat tradicionale, përmes një strategjie të integruar komunikimi që rrit njohjen e markës dhe pozicionimin e ASF-së në treg;
- Ndjekjen dhe thellimin e partneriteteve ekzistuese, si dhe identifikimin e partnerëve dhe donatorëve të rinj potencialë për zhvillimin e projekteve të reja.

08
Agro & Social Fund SHA

Crimson Finance Fund Albania

“I vetmi institucion financiar jo-bankë pjesë e projektit “Sustainable Reboot SME” të EBRD.”

Crimson Finance Fund Albania (CFFA) është një institucion financiar me një mision social për të rritur aksesin në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, start-upet dhe aktivitetet që gjenerojnë vende të reja pune. CFFA kërkon të mbështesë këto grupe ndërmarrjesh me financime dhe këshillim financiar duke i ndihmuar të dalin nga « rrethi vicioz i të qendruarit të vegjël ». Me një gamë të gjerë produktesh si kredi me këste, qira financiare (leasing), linjë kredie dhe faktoring, CFFA synon të mbulojë nevojat e këtyre ndërmarrjeve në investime, kapital qarkullues, apo shtim dhe përmirësim të aseteve fikse.



Rrjeti i degëve të Crimson Finance Fund Albania.

Crimson Finance Fund Albania financon sektorin e manifakturës tre herë më shumë se mesatarja e tregut financiar në proporcion me portofolin e saj, si edhe i dedikon rreth 25% të disbursimeve të saj start-upeve, duke u bërë kështu një promotor dhe një derë e hapur për këto të fundit, të cilët përfitojnë përveç financimit edhe një konsulencë të personalizuar falas në lidhje me planin e tyre të biznesit dhe projeksionet financiare.

Viti 2025 ka shënuar një vit tjetër të suksesshëm për CFFA përsa i përket rritjes së portofolit dhe zgjerimit të aktivitetit të saj. Përgjatë këtij viti, portofoli i CFFA u rrit me 36%, duke arritur vlerën 1.5 Miliardë Lekë (nga 1.08 Miliardë Lekë në 2024). Niveli i disbursimeve u rrit gjithashtu ndjeshëm me 23% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 887.2 Milionë Lekë (nga 720.3 Milionë Lekë në 2024), me një mesatare mujore disbursimesh prej 73.9 Milionë Lekë, gjithashtu në rritje me 23% krahasuar me vitin paraardhës. Cilësia e portofolit mbeti e qëndrueshme përgjatë gjithë vitit, me nivelin e kredive me probleme (NPL) pothuajse i pandryshuar, në 3.73% në mbyllje të vitit 2025 (nga 3.72% në 2024) — një tregues i fortë i menaxhimit të kujdesshëm të riskut.

Përgjatë vitit 2025, CFFA hapi degën e saj të tretë në nivel vendi, në qytetin e Lushnjes. Përmes kësaj dege, CFFA synon t'u shërbejë klientëve të rrethit të Lushnjes, duke rritur mundësitë për zhvillim ekonomik në zonë, zgjeruar skopin e klientëve, dhe duke u bërë më aktive në sektorin e bujqësisë, një sektor me potencial të lartë por ende të pashërbyer mjaftueshëm në rajon. Në vazhdim të kësaj strategjie zgjerimi, gjatë vitit 2026 CFFA po punon për hapjen e një dege të re në një qytet tjetër, duke synuar rritjen e mëtejshme të prezencës së saj në nivel kombëtar.

Një arritje veçanërisht e rëndësishme e vitit 2025 ishte sigurimi i një financimi nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) në vlerën e 2 Milionë EUR. Me krenari mund të theksohet se CFFA është i vetmi institucion financiar jo-bankë pjesë e projektit “Sustainable Reboot SME te EBRD, çka tregon qartë nivelin e maturitetit institucional të CFFA dhe besueshmërinë e saj në sytë e partnerëve ndërkombëtarë financiarë. Ky financim vjen në vazhdimësi të konsolidimit të marrëdhënieve të CFFA me partnerë financiarë vendas dhe të huaj, si dhe pjesëmarrjes së saj në forume dhe konferenca ndërkombëtare të sektorit.

Gjatë vitit 2025, CFFA nisi gjithashtu zhvillime të rëndësishme në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), me qëllim thellimin e mëtejshëm të dixhitalizimit dhe ndjekjen e hapave të transformimit digjital të institucionit. Në vijim të këtij procesi, në vitin 2026 pritet që CFFA t'u dalë klientëve të saj me një Aplikacion Mobile të dedikuar, i disponueshëm në të dy platformat kryesore, Google Play Store dhe Apple App Store, duke lehtësuar kështu më tej aksesin dhe eksperiencën e klientëve me shërbimet e institucionit.

Viti 2025 shënoi gjithashtu një hap tjetër të rëndësishëm përsa i përket Impaktit Social dhe Mjedisor, ku në fund të vitit CFFA arriti të publikojë një Raport Impakti profesional, të realizuar falë asistencës profesionale të specializuar në këtë fushë. Përveç një strukturimi më të mirë të tregimit (storytelling) të ndryshimit që CFFA sjell në komunitetet ku operon, ky raport përfshin edhe një game më të gjerë të treguesve kryesorë të performancës (KPI), të cilët në të ardhmen do të shtohen dhe do të pasurohen më tej, duke mundësuar që të reflektohet edhe më qartë dhe në mënyrë më të matshme puna e CFFA lidhur me impaktin e saj social dhe mjedisor.

CFFA synon të vazhdojë me vendosmëri përmbushjen e misionit të saj përgjatë vitit 2026, duke u bërë një aktor gjithnjë e më i rëndësishëm në tregun financiar vendas, me pozicionim midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare përsa i përket vlerës së financimit dhe kushteve të ofruara. CFFA do të vazhdojë të përqendrojë aktivitetin e saj në financimin e aseteve, aktiviteteve prodhuese dhe start-up-eve, duke bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare financiare që mbështesin financën sociale, dhe duke synuar rritjen e mëtejshme të impaktit të huave të saj, me qëllim ngushtimin e hendekut të aksesit në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla në Shqipëri.

FED invest SHKK

100,278

anëtarë — për herë të parë mbi 100 mijë

ECURIA E PËRGJITHSHME E VEPRIMTARISË DHE INDIKATORËT KRYESORË

Viti 2025 përbën një moment të rëndësishëm në historinë e FED invest, duke shënuar 10-vjetorin e konsolidimit institucional dhe 33 vite traditë në financën sociale shqiptare. Gjatë këtij viti, institucioni vijoi trajektoren e tij të rritjes së qëndrueshme, duke forcuar pozicionin si kooperativa financiare më e madhe në Shqipëri dhe një nga institucionet më të rëndësishme të mikrofinancës në vend.

Numri i anëtarëve arriti në 100,278, duke kapërcyer për herë të parë shifrën prej 100 mijë anëtarësh, një gur kilometrik në zhvillimin e organizatës, dhe duke shënuar një rritje prej 4.6% krahasuar me vitin e kaluar. FED invest vazhdoi të ofrojë shërbime financiare përmes një rrjeti prej 54 degësh në të gjithë vendin, duke mbuluar me shërbime financiare dhe jo-financiare mijëra komunitete rurale dhe urbane.

Aktivet totale arritën në 9.9 miliardë lekë, ndërsa portofoli i kredisë u rrit në rreth 7 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 9.3%. Portofoli i depozitave arriti në 5.6 miliardë lekë, duke reflektuar besimin e vazhdueshëm të anëtarëve ndaj institucionit. Mjaftueshmëria e kapitalit mbeti në nivelin 21%, ndërsa rezultati neto i vitit arriti në 59.6 milionë lekë.

Gjatë vitit u disbursuan mbi 3,800 kredi të reja me vlerë rreth 3.35 miliardë lekë, duke mbështetur fermerët, gratë sipërmarrëse, mikro-bizneset dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme në të gjithë territorin e vendit.

ZHVILLIME NË SHËRBIME, PRODUKTE DHE TRANSFORMIM DIGJITAL

Gjatë vitit 2025, FED invest vijoi përmirësimin e ofertës së produkteve dhe shërbimeve financiare, duke i përshtatur ato me nevojat në ndryshim të anëtarëve. Institucioni forcoi pozicionin në financimin e bujqësisë, agrobiznesit dhe SME-ve, duke ofruar produkte më fleksibël dhe të personalizuara.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua transformimit digjital dhe modernizimit të proceseve të brendshme. Investimet në teknologji dhe siguri informacioni synuan rritjen e efikasitetit operacional, përmirësimin e përvojës së anëtarëve dhe krijimin e bazave për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale.

Gjatë vitit u realizuan mbi 27 mijë transaksione të pagesave utilitare, ndërsa u zgjerua përdorimi i llogarive rrjedhëse dhe i produkteve të tjera financiare që forcojnë marrëdhënien afatgjatë me anëtarët.

QEVERISJA, MENAXHIMI I RISKUT DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

FED invest vijoi të forcojë strukturat e qeverisjes kooperative, duke mbajtur anëtarin në qendër të çdo vendimmarrjeje. Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Drejtues, Komiteti i Kontrollit dhe strukturat këshillimore kontribuan në garantimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm institucional.

Gjatë vitit 2025 u përmirësuan më tej politikat dhe procedurat e menaxhimit të riskut, duke forcuar monitorimin e portofolit, kontrollin operacional dhe sigurinë teknologjike. Institucioni vijoi të ruajë standarde të larta të përputhshmërisë me kuadrin rregullator dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Kapitali njerëzor mbetet një nga asetet më të rëndësishme të FED invest. Gjatë vitit u organizuan 27 programe trajnimi me pjesëmarrjen e 630 punonjësve. Rreth 66% e stafit përbëhet nga gra, ndërsa niveli i kënaqësisë së punonjësve shënoi rritje krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar investimet në zhvillimin profesional dhe kulturën organizative.

NDIKIMI SOCIAL, ESG DHE PARTNERITETET STRATEGJIKE

Misioni social mbetet në themel të veprimtarisë së FED invest. Institucioni vijoi të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të komuniteteve lokale përmes financimit të përgjegjshëm, edukimit financiar dhe shërbimeve këshilluese.

Një rol të rëndësishëm vazhdoi të luajë Qendra ABA dhe platforma ABA Online, të cilat gjatë pesë viteve të funksionimit janë shndërruar në një qendër të rëndësishme informacioni, trajnimi dhe këshillimi për fermerët dhe agrobizneset. Platforma numëron mbi 22 mijë përdorues dhe ka ofruar qindra aktivitete edukative, demonstrime dhe materiale këshilluese.

Viti 2025 u karakterizua gjithashtu nga zgjerimi i partneriteteve strategjike ndërkombëtare. FED invest nënshkroi marrëveshjen e financimit prej 10 milionë eurosh me Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (CEB), e cila synon mbështetjen e mbi 3,000 fermerëve, mikro-ndërmarrjeve dhe bizneseve të vogla, me fokus të veçantë tek gratë sipërmarrëse dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Gjithashtu, u zgjeruan dhe u thelluan bashkëpunimet me Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës, EFSE, JICA, Helenos dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë për financim, asistencë teknike, zhvillim të financës së gjelbër, transformim digjital dhe përfshirje financiare.

Në fushën e ESG-së, FED invest vijoi të promovojë financimin e qëndrueshëm, mbështetjen e bujqësisë së gjelbër, fuqizimin ekonomik të grave dhe përmirësimin e qeverisjes institucionale, duke integruar gradualisht standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë në aktivitetin e tij.

Prioritetet për vitin 2026

Për vitin 2026, FED invest do të fokusohet në:

- Rritjen e mëtejshme të anëtarësisë dhe forcimin e marrëdhënies me anëtarët ekzistues;
- Përmirësimin e cilësisë së portofolit dhe forcimin e sistemeve të menaxhimit të riskut;
- Zhvillimin e produkteve të reja financiare për fermerët, SME-të dhe individët;
- Investime të mëtejshme në transformimin digjital dhe sigurinë kibernetike;
- Zgjerimin e financës së gjelbër dhe iniciativave ESG;
- Fuqizimin e partneriteteve ndërkombëtare për financim dhe asistencë teknike;
- Rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj anëtarëve.

Me një bazë të fortë financiare, një model unik kooperativë dhe një mision të qartë social, FED invest hyn në vitin 2026 me objektivin për të vazhduar të krijojë vlerë ekonomike dhe sociale për anëtarët, komunitetet dhe ekonominë shqiptare në tërësi.

Treguesit analitikë dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2025

TREGUESI	VLERA
Anëtarë	100,278
Gratë në anëtarësi	rreth 38%
Rritja e anëtarëve	+4.6%
Llogari rrjedhëse	21,000+
lekë aktive totale	9.9 mld
lekë portofol depozitash	5.6 mld
lekë portofol kredie	7 mld
Mjaftueshmëri kapitali	21%

Burimi: FED invest SHKK

Fondi Besa

"Çdo kredi e disbursuar gjatë vitit 2025 përfaqëson një histori zhvillimi."

Financimi që krijon mundësi, zhvillim dhe qëndrueshmëri

Viti 2025 ishte një vit tjetër i rëndësishëm në historinë e Fondit Besa, duke konfirmuar rolin e institucionit si një nga motorët kryesorë të përfshirjes financiare dhe zhvillimit të sipërmarrjes në Shqipëri.

Në një mjedis ekonomik që ndryshon vazhdimisht, Fondi Besa vijoi të jetë pranë mijëra familjeve, fermerëve dhe bizneseve të vogla, duke u ofruar jo vetëm financim, por edhe besimin dhe mbështetjen e nevojshme për të investuar, për t'u zgjeruar dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre.

Çdo kredi e disbursuar gjatë vitit 2025 përfaqëson një histori zhvillimi: një biznes që zgjeroi aktivitetin, një fermer që investoi në prodhim, një familje që realizoi një projekt të rëndësishëm. Kjo është vlera reale që Fondi Besa synon të krijojë çdo ditë.

NJË VIT RRITJEJE DHE NDIKIMI TË PREKSHËM

Performanca e vitit 2025 dëshmon për besimin e klientëve dhe përkushtimin e institucionit për të ofruar shërbime financiare të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Gjatë vitit:

- U disbursuan 9.72 miliardë lekë kredi, duke mbështetur mbi 17,372 klientë në të gjithë vendin dhe duke shënuar një rritje prej 18.57% krahasuar me vitin 2024.
- Portofoli aktiv i kredisë arriti në 16.20 miliardë lekë, me 27,744 klientë aktivë dhe një rritje prej 9.31%.
- Totali i aktiveve u rrit me 12.2%, duke reflektuar zgjerimin e qëndrueshëm të aktivitetit.
- U zgjeruan kanalet digjitale dhe proceset online, duke e bërë financimin më të shpejtë dhe më të aksesueshëm.
- U forcua mbështetja për sektorët strategjikë të ekonomisë, veçanërisht bujqësinë, tregtinë dhe bizneset mikro.

Këto rezultate pasqyrojnë jo vetëm rritjen financiare të institucionit, por edhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të komuniteteve ku operon.

MISIONI YNË: TË KRIJOJMË MUNDËSI ATY KU ATO NEVOJITEN MË SHUMË

Në thelb të veprimtarisë së Fondit Besa qëndron bindja se çdo individ apo sipërmarrës meriton mundësinë për të zhvilluar potencialin e tij.

Për këtë arsye, ne vazhdojmë të ndërtojmë ura financimi për ata që shpesh kanë akses të kufizuar në shërbimet tradicionale financiare. Për ne, financimi nuk është thjesht një transaksion – është një mjet që krijon punësim, gjeneron të ardhura dhe përmirëson cilësinë e jetës.

TEKNOLOGJIA NË SHËRBIM TË KLIENTIT

Transformimi digjital mbeti një nga shtyllat kryesore të zhvillimit gjatë vitit 2025.

Investimet në teknologji u fokusuan në krijimin e një eksperience më të thjeshtë, më të shpejtë dhe më efikase për klientët, përmes:

- Digjitalizimit të proceseve të aplikimit dhe miratimit të kredive;
- Përmirësimit të komunikimit në kohë reale;
- Automatizimit të proceseve operacionale;
- Forcimit të sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve financiare.

Për Fondin Besa, teknologjia nuk zëvendëson marrëdhënien njerëzore – ajo e bën atë më të shpejtë, më efektive dhe më pranë klientit.

NJERËZIT – KAPITALI YNË MË I VLEFSHËM

Pas çdo rezultati të arritur qëndron një ekip profesionistësh të përkushtuar që punojnë çdo ditë pranë klientëve dhe komuniteteve.

Gjatë vitit 2025, Fondi Besa vijoi investimet në zhvillimin profesional të stafit, përmirësimin e strukturës organizative dhe forcimin e kapaciteteve të linjës së parë të shërbimit. Kjo qasje ka kontribuar në rritjen e produktivitetit, cilësisë së shërbimit dhe këshillimit financiar që institucioni ofron.

PRANË KLIENTËVE, KUDO NË SHQIPËRI

Rrjeti i gjerë i zyrave mbetet një nga avantazhet më të mëdha të Fondit Besa.

Prania në të gjithë territorin e vendit mundëson njohjen e drejtpërdrejtë të nevojave të klientëve dhe ofrimin e zgjidhjeve financiare të përshtatura me realitetin ekonomik të çdo zone.

Kjo afërsi ka krijuar marrëdhënie të forta besimi dhe e ka pozicionuar Fondin Besa si një partner afatgjatë zhvillimi për mijëra klientë.

RRITJE ME PËRGJEGJËSI

Qëndrueshmëria dhe përgjegjshmëria sociale vazhdojnë të jenë pjesë integrale e modelit të biznesit të Fondit Besa.

GJATË VITIT 2025, FOKUSI MBETI TEK:

- Financimi i aktiviteteve që krijojnë vlerë ekonomike dhe sociale;
- Mbështetja e fermerëve dhe sipërmarrjeve lokale;
- Edukimi financiar i klientëve;
- Zbatimi i praktikave të përgjegjshme të huadhënies.

Objektivi ynë është të krijojmë ndikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm për klientët, komunitetet dhe ekonominë shqiptare.

DUKE PARË DREJT SË ARDHMES

Periudha 2026–2028 do të shënojë një fazë të re zhvillimi për Fondin Besa.

Prioritetet strategjike do të fokusohen në:

- Zgjerimin e aksesit financiar në zonat me nivel më të ulët përfshirjeje bankare;
- Thellimin e transformimit digjital dhe automatizimit të proceseve;
- Diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve financiare;
- Rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapitalit njerëzor;
- Forcimin e ndikimit social dhe ekonomik në komunitetet ku operojmë.

Me të njëjtin përkushtim që e ka karakterizuar ndër vite, Fondi Besa do të vazhdojë të mbështesë sipërmarrjen shqiptare, të krijojë mundësi zhvillimi dhe të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie më gjithëpërfshirëse, më konkurruese dhe më të qëndrueshme.





Ekipi i Fondit Besa gjatë vitit 2025.

iute Albania

98.2%

e kontratave u nënshkruan elektronikisht

IuteCredit Albania sh.a u themelua në vitin 2014 dhe nisi aktivitetin në Prill 2015. Kompania është e licencuar nga Banka e Shqipërisë si një institucion mikrofinanciar jobankar (licenca nr. 32, datë 31.03.2015) dhe është në pronësi të plotë të iute Group AS, një kompani estoneze që emeton obligacionet e saj në Bursën e Frankfurtit dhe Nasdaq Tallinn.

iute ofron kredi konsumatore pa kolateral, me afate shlyerjeje deri në 48 muaj, dhe operon përmes aplikacionit Myiute dhe një rrjeti të gjerë partnerësh tregtarë në të gjithë vendin. Qëllimi kryesor është të ofrojë shërbime financiare të thjeshta, të shpejta dhe plotësisht digjitale, të përshtatura sipas nevojave të klientëve shqiptarë.

MISIONI & VIZIONI

- Misioni: Të krijojmë përvojën më të mirë për financat personale, duke kombinuar teknologjinë financiare me të vepruarit njerëzor. Të ndihmojmë klientët tanë të bëhen financiarisht dhe teknologjikisht më të fortë.
- Vizioni: Një e ardhme ku njerëzit përdorin shërbimet financiare menjëherë, me besim dhe në mënyrë të pavarur, dhe kthehen në iute falë përvojës së jashtëzakonshme.

ZHVILLIME KYÇE GJATË VITIT 2025

Viti 2025 u karakterizua nga rritje e qëndrueshme dhe përparim i mëtejshëm në digjitalizimin e iuteCredit Albania.

- Gjatë vitit, kompania shërbeu mbi 150,000 kredi, prej të cilave afro 50 % ishin pjesë e metodës “Bli Tani Paguaj Më Vonë (BNPL)”, duke reflektuar kërkesën për financim fleksibël në pikën e shitjes.
- Mbi 98.2% e kontratave u nënshkruan elektronikisht, duke treguar fokusin e vazhdueshëm të kompanisë tek efikasiteti digjital dhe autonomia e klientit.
- Përmes një rrjeti kombëtar me mbi 1,800 partnerë tregtarë dhe më shumë se 2,500 pika aktive shitjeje, iuteCredit Albania zgjeron praninë e saj në çdo rajon të vendit.
- Kompania diversifikoi portofolin e saj të financave digjitale duke lançuar në fund të vitit 2025, sigurimin digjital TPL të makinës, i cili mund të sigurohej në kohë reale nga klientët falë pagesës elektronike apo blerjes me këste sipas metodës BNPL.
- Gjatë vitit 2025, kompania lançoi programin e besnikërisë iutePlus, duke zgjeruar më tej gamën e përfitimeve të ofruara për klientët.

PERFORMANCA OPERACIONALE & FINANCIARE

iuteCredit Albania vazhdoi të digjitalizojë të gjithë ciklin e kredisë, nga faza e aplikimit deri në fazën e miratimit, përmes automatizimit, analizës së të dhënave dhe mjeteve të vetëshërbimit. Këto përpjekje kontribuan në një proces më të thjeshtuar huadhënieje dhe ulje të kostove operacionale.

- Kompania ruajti një strukturë efikase me 139 punonjës, duke operuar me vetëm 9 degë, të mbështetur nga operacione të fuqishme të kujdesit ndaj klientit, të cilat trajtuan mbi 5 milionë ndërveprime përmes telefonit, chat-it, email-it dhe platformave të mesazheve.
- Mbi 70 mijë përdorues aktivë përdorën aplikacionin Myiute në Shqipëri.

- Kënaqësia e klientëve mbeti e lartë, me një Net Promoter Score (NPS) mbi 85.
- Gjatë vitit 2025, u regjistruan në portofolin e kompanisë mbi 92 mijë klientë aktivë.
- Gjatë vitit 2025, iute operonte një rrjet prej 59 ATM-sh, ndërsa përmes shërbimeve të saj procesoheshin mesatarisht 5,000 transaksione në muaj.
- Fondet e huamarrjes për të ruajtur likuiditetin janë pjesë standarde e strategjisë financiare të kompanisë, të siguruara nga tregjet vendase dhe ndërkombëtare.
- 2025 ishte viti ku filluan edhe projektet e para me AI duke u bërë një ndër pionerët e sektorit financiar, përfshirë edhe atë bankar në vend.
- Normat e interesit mbetën në pothuajse të njejtat nivele për huamarrjet ndërkombëtare krahasuar me 2024, ndërsa u regjistrua një ulje e lehtë e normave të interesit në huamarrjet vendore, duke treguar besimin e tregut tek institucionet financiare jobankare.
- Kjo situatë favorizuese i mundësoi kompanisë të rrisë huamarrjet vendore me kosto më të ulët, duke reflektuar përfitimin te klientët përmes ofertave më konkurruese të kredisë.
- Portofoli neto i kredive u rrit me afro 19% në krahasim me një vit më parë, i nxitur nga kërkesa e qëndrueshme dhe menaxhimi efikas i kredisë.
- Cilësia e kredisë mbeti e fortë, me raportin e huave me probleme (NPL) që u përmirësua në 9.1% deri në fund të vitit 2025, nga 9.4 % në fund të vitit 2024.
- Në vitin 2025, totali i aktiveve u rrit me 24% krahasuar me vitin 2024.
- Të ardhurat totale mbetën të qëndrueshme me një rritje të lehtë prej 4%.
- Veçanërisht, në vitin 2025, kompania siguroi linja të ndryshme kredie nga bankat e vendit, element ky që tregon besimin e sektorit bankar te iute dhe modeli i saj i biznesit.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Në vitin 2025, iuteCredit Albania zgjeroi ndikimin e saj në komunitet përmes nismave që ndërthurën arsimin, përfshirjen sociale dhe aftësimin digjital, duke mbështetur përshtatjen e komunitetit me zhvillimet teknologjike dhe fuqizimin e aftësive digjitale.

- *Edukimi financiar:* Në kuadër të angazhimit për edukimin financiar, iute iu bashkua fushatës ndërkombëtare “Bëhu një huamarrës i mençur”, së bashku me Microfinance Centre dhe mbi 15 institucione financiare në Evropë dhe Azi Qendrore, me synim promovimin e marrjes së informuar dhe të përgjegjshme të vendimeve financiare.
- Në vitin 2025, iute forcoi angazhimin në edukimin financiar dhe digjital përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar, me fokus në promovimin e njohurive mbi teknologjitë financiare (FinTech), inovacionin dhe potencialin e tyre për të transformuar të ardhmen.
- Gjithashtu, gjatë 2025, iute nisi një bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës përmes platformës iutech, me fokus në zhvillimin e aftësive teknologjike dhe njohurive mbi FinTech të studentëve, duke i përgatitur ata për kërkesat e ekonomisë dhe tregut të ardhshëm të punës.
- Në Mars të vitit 2025, përmes platformës iutech, kompania kontribuoi në edukimin financiar dhe përgatitjen e studentëve të Tirana Bussines University për tregun e së ardhmes, duke zhvilluar leksione dhe diskutime mbi FinTech dhe zhvillimet e financave digjitale.
- Në kuadër të angazhimit për edukimin financiar dhe zhvillimin e aftësive digjitale, në Prill 2025, platforma iutech solli leksionin “E ardhmja është FinTech” për studentët e Fakultetit të Ekonomisë në Vlorë.
- *Shëndeti dhe sporti:* Gjatë vitit 2025, punonjësit e iute u përgatitën së bashku me kampionen e atletikës Luiza Gega për të marrë pjesë në Maratonën e Tiranës, duke e kthyer aktivitetin sportiv në një mundësi për të promovuar shëndetin, mirëqenien dhe angazhimin ndaj kauzave sociale.
- *Mbështetje sociale dhe solidaritet komunitar:* iute mbështeti Fshatin SOS përmes dhurimit të librave për fëmijët,

duke kontribuar në edukimin, mirëqenien dhe përfshirjen e tyre sociale.

- iute vijoi mbështetjen për Down Syndrome Albania përmes nismës simbolike të çorapeve shumëngjyrëshe, duke promovuar përfshirjen sociale dhe ndërgjegjësimin për Sindromën Down.
- Dhuro gjak: Në kuadër të angazhimit social dhe humanitar, stafi i iute iu bashkua aksioneve të dhurimit vullnetar të gjakut të organizuara në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.
- *Arti dhe kultura:* iute mbështeti ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare përmes mbështetjes së restaurimit dhe shfaqjes në 4K të filmit të animuar "Ilira", në kuadër të 50-vjetorit të animacionit shqiptar.
- iute mbështeti edicionin e pestë të Porto Palermo Festival, duke kontribuar në promovimin e muzikës, artit dhe vlerave kulturore shqiptare në një hapësirë me rëndësi të veçantë historike.
- iute mbështeti, në bashkëpunim me YWCA Albania, projektin artistik kushtuar Tefta Tashko Koços, duke kontribuar në ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit dhe mbështetjen psikologjike të grave që përballen me këtë sëmundje.

Imazhet që simbolizojnë rrugëtimin e iute gjatë 2025





08
iute Albania







Kredo.al

ECFA sha · Kredo.al

Aktivitetet, arritjet dhe drejtimi strategjik për 2026

81%
e stafit: "krenar/e që punon në Kredo"

169,926
aplikime të procesuara

110,255
kredi të disbursuara

80%
klientë të përsëritur

230 / 38
punonjës / degë

01 · Aktivitetet dhe arritjet e vitit 2025

Viti 2025 konfirmoi qëndrueshmërinë e modelit të biznesit dhe besimin e vazhdueshëm të klientëve ndaj ECFA sha.

- Janë procesuar 169,926 aplikime dhe janë lëvruar 110,255 kredi gjatë vitit, në vlerë totale prej rreth 55–58 milionë Euro.
- Rreth 80% e kredive iu përkasin klientëve të përsëritur — tregues i drejtpërdrejtë i besimit afatgjatë ndaj institucionit.
- Muaji Dhjetor shënoi shifrën rekord të vitit, i nxitur kryesisht nga produkti Kredia me Këste.
- U integrua për herë të parë raporti Kredi/të Ardhura (DTI) në procesin e kreditimit, duke forcuar huamarrjen e përgjegjshme.
- Rrjeti mbeti i qëndrueshëm: 230 punonjës në 38 degë në mbarë vendin, në të njëjtin nivel me vitin 2024.
- U finalizua procesi i identifikimit 100% online me EvroTrust — verifikim dokumenti, biometrikë dhe firmë dixhitale.

02 · Evente, trajnime dhe iniciativa kryesore

ECFA sha vazhdoi të investojë në komunitet dhe në ekipin e saj, si pjesë thelbësore e identitetit organizativ.

NË KOMUNITET

- Sponsor kryesor i Kampit Veror & Shërbimit Komunitar në Tropojë, për fëmijë 7–13 vjeç.
- Fushata "Back to School" — paketa shkollore me SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.



Kampi Veror & Shërbimi Komunitar, Tropojë 2025

- Trajnim profesional për 20 gra/vajza në artizanat; 8 prej tyre kanë aplikuar për punë.
- Event ndërgjegjësimi për Kancerin e Gjirit, me Institutin e Shëndetit Publik.
- Pjesëmarrje në GITEKA Project dhe "Drejtues për një Ditë" me Junior Achievement Albania.

ME EKIPIN TONË

- Tema e trajnimit 2025: "Zhvillimi Individual" — fokus tek vetëmotivimi dhe performanca.
- Festa e 8-vjetorit të kompanisë dhe çmimet tremujore "Festojmë më të Mirët" (Sarandë, Dhërmi, Melia).
- Retreat strategjik i ekipit drejtues në Maltë dhe takimi i Buxhetit/OKR-ve në Gjirin e Lalzit.
- Panaire karriere në Western Balkans University, Marin Barleti, UET, si dhe në HRHubAlbania.
- 81% e stafit u shpreh "krenar/e që punon në Kredo", sipas anketës më të fundit të angazhimit.

03 · Produkte dhe zhvillime të reja

2025 solli risi konkrete në portofolin e produkteve dhe në infrastrukturën teknologjike të kompanisë.

- Lançimi i "Kredisë me Këste Premium" (Nëntor 2025) — produkti me potencialin më të lartë për rritje.
- Produkt i ri: kredi individuale deri 600,000 Lekë, me afat shlyerjeje deri në 60 muaj.
- Integrimi i raportit Kredi/të Ardhura (DTI) si standard në vlerësimin e çdo aplikimi për kredi.
- Proces identifikimi 100% dixhital me EvroTrust: dokument identiteti, biometrikë dhe firmë elektronike.
- Certifikim sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2022 për sigurinë e informacionit.
- Hapja e degës së dytë në Fier, si pjesë e zgjerimit të rrjetit kombëtar të shërbimit.

PERSPEKTIVA PËR 2026

Drejtoresha e Përgjithshme, Arlinda Muja, e sheh 2026 si një tjetër kapitull suksesi për ECFA sha, të mbështetur mbi të njëjtin profesionalizëm, frymë bashkëpunuese dhe fokus strategjik që karakterizuan vitin 2025.

— ARLINDA MUJA, DREJTORE E PËRGJITHSHME, ECFA SHA

04 · Fokusi dhe prioritetet për 2026

Viti 2026 do të fokusohet te konsolidimi i transformimit dixhital dhe forcimi i menaxhimit të riskut.

- Lançimi i aplikacionit mobile Kredo.al — aplikim, monitorim krediti dhe edukim financiar në kohë reale.
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale për analiza më të sakta të riskut dhe vendimmarrje më të shpejtë.
- Forcim i mëtejshëm i sigurisë kibernetike: DLP e plotë, testim i Disaster Recovery dhe model Zero Trust i avancuar.
- Zgjerim i mëtejshëm i rrjetit të degëve dhe i partneriteteve të reja të shpërndarjes.
- Bashkimi i të gjitha kanaleve të komunikimit me klientin në një platformë të vetme, në kohë reale.
- Vazhdimësi në edukimin financiar dhe përfshirjen aktive të klientit në zhvillimin e shërbimeve.

05 · Foto dhe materiale vizuale

Momente nga aktivitetet e komunitetit dhe të ekipit gjatë 2025.



Fushata Back to School



Trajnimi Zhvillimi Individual



Trajnim profesional, SOS Shqipëri

MiA Finance

"Tetori Rozë": komisioni i disbursimit u ul në 1% për të gjitha aplikantet femra."

Ecuria e aktivitetit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, aktiviteti i institucionit ka vijuar me ritme të qëndrueshme rritjeje dhe me fokus të veçantë në financimin e individëve, bizneseve të vogla dhe sektorit të bujqësisë.

Rrjeti operativ përbëhej nga 12 degë, të mbështetura nga 62 punonjës në total, prej të cilëve 38 janë femra, duke reflektuar një përfaqësim të konsiderueshëm të grave në strukturën organizative të institucionit dhe duke garantuar mbulim të gjerë gjeografik dhe shërbim cilësor ndaj klientëve.

Në fund të periudhës, portofoli aktiv i kredive arriti në 646.2 milionë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë kreditë për biznese me 378.9 milionë lekë (58.6%), të ndjekura nga kreditë për individë me 230.1 milionë lekë (35.6%) dhe kreditë për bujqësi e blegtori me 37.2 milionë lekë (5.8%). Kjo strukturë tregon orientimin e institucionit drejt mbështetjes së sipërmarrjes dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Numri i klientëve aktivë arriti në 1,478, ku 1,114 janë klientë individë, 322 klientë biznesi dhe 42 klientë në sektorin e bujqësisë. Kjo bazë klientësh reflekton besimin e vazhdueshëm të tregut ndaj produkteve dhe shërbimeve financiare të institucionit.

Gjatë vitit u disbursuan gjithsej 569.9 milionë lekë kredi, të shpërndara në 1,077 kredi të reja. Kreditë për biznese përbënin vlerën më të lartë të financimeve të reja me 331.4 milionë lekë, ndërsa kreditë për individë arritën në 209 milionë lekë dhe ato për bujqësi në 29.5 milionë lekë. Numri i lartë i kredive të disbursuara dëshmon një aktivitet intensiv kredidhënës dhe një kërkesë të qëndrueshme për financim në treg.

Nga pikëpamja e cilësisë së portofolit, portofoli në rrezik mbi 90 ditë (PAR 90+) rezultoi në nivelin 5.61%, duke ruajtur një nivel të kontrolluar të kredive me probleme në raport me aktivitetin e përgjithshëm.

Në aspektin e ndikimit social, institucioni vazhdoi të kontribuojë në përfshirjen financiare të komuniteteve lokale. Nga klientët aktivë, 341 janë gra dhe 1,137 burra, ndërsa 1,250 klientë operojnë në zona urbane dhe 228 klientë në zona rurale. Financimet e ofruara kanë ndihmuar në mbështetjen e aktiviteteve ekonomike, krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës, si dhe në përmirësimin e mirëqenies së familjeve të përfshira në programet e kreditimit.

Në tërësi, viti 2025 karakterizohet nga rritje e aktivitetit kredidhënës, zgjerim i bazës së klientëve dhe ruajtje e një portofoli të diversifikuar, duke konfirmuar rolin e institucionit si një partner i rëndësishëm financiar për individët, bizneset e vogla dhe sektorin e bujqësisë në Shqipëri.

Duke u mbështetur në rezultatet e arritura gjatë vitit 2025, perspektiva për vitin 2026 paraqitet mjaft pozitive, me pritshmëri për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit, forcim të pozicionit në treg dhe rritje të ndikimit ekonomik e social të institucionit.

Fokusi kryesor do të mbetet zhvillimi i qëndrueshëm i aktivitetit kredidhënës, përmes rritjes së pranisë në treg, forcimit të marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe tërheqjes së klientëve të rinj. Pritet që kërkesa për financim të vijojë të mbetet e lartë, veçanërisht nga individët, bizneset e vogla dhe sektori i bujqësisë, duke krijuar mundësi për zgjerimin e portofolit dhe diversifikimin e mëtejshëm të tij.

Njëkohësisht, institucioni synon të vazhdojë përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientit, duke investuar në zhvillimin profesional të stafit, optimizimin e proceseve të brendshme dhe përdorimin më efikas të teknologjisë në funksion të operacioneve të përditshme.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të riskut dhe ruajtjes së cilësisë së portofolit, përmes monitorimit të vazhdueshëm të performancës së kredive dhe zbatimit të praktikave të kujdesshme të kreditimit. Kjo do të kontribuojë në forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjen e besimit të klientëve dhe partnerëve institucionalë.

Në aspektin e ndikimit social, pritet të zgjerohet më tej përfshirja financiare e individëve dhe bizneseve që kanë akses më të kufizuar në financim, duke mbështetur zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve ku institucioni operon.

Në tërësi, viti 2026 parashikohet të jetë një vit konsolidimi dhe rritjeje, i karakterizuar nga zhvillim i qëndrueshëm, efikasitet më i lartë operacional dhe forcim i rolit të institucionit si një partner financiar i besueshëm në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe përfshirjes financiare në Shqipëri.

AKTIVITETE PROMOVUESE DHE MARKETINGU

Gjatë periudhës 24 - 26 Prill 2025, MiA Finance mori pjesë për të dytin vit radhazi në panairin "Ditët e Bujqësisë", të organizuar në qytetin e Lushnjës. Pjesëmarrja u realizua në bashkëpunim me kompaninë Iceberg Exhibitions, ku institucioni promovoi produktet dhe shërbimet e tij financiare përmes stendave të dedikuara dhe angazhimit aktiv të stafit të MiA Finance. Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e vizibilitetit të institucionit, forcimin e marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe krijimin e mundësive për zgjerimin e bazës së klientëve potencialë.

FUSHATA PROMOCIONALE "TETORI ROZË"

Në kuadër të angazhimit të MiA Finance për mbështetjen e grave dhe promovimin e përfshirjes financiare, gjatë muajit Tetor 2025 u zbatua fushata promocionale "Tetori Rozë". Nëpërmjet kësaj nisme, u ofrua një lehtësim në kostot e financimit për të gjitha aplikantet femra që aplikuan për kredi gjatë periudhës 2 - 31 Tetor.

Si pjesë e fushatës, komisioni i disbursimit u ul në nivelin 1% për të gjitha produktet e kredisë, duke krijuar kushte më të favorshme financimi për gratë kredimarrëse. Kjo iniciativë synoi të nxisë aksesin në financim, të mbështesë aktivitetet ekonomike të drejtuara nga gratë dhe të forcojë rolin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social.

Fushata u mirëprit nga klientet dhe kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit mbi mundësitë e financimit të ofruara nga institucioni, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm të MiA Finance ndaj përgjegjësisë sociale dhe mbështetjes së komunitetit.

TRAJNIME DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të performancës në shitje, më 11 Prill 2025 u organizua një workshop me temë "Shitjet Efektive", i zhvilluar nga një trajner i jashtëm. Në këtë trajnim morën pjesë drejtorët e degëve të MiA Finance, të cilët përfituan njohuri dhe praktika bashkëkohore mbi teknikat e avancuara të shitjes, komunikimin me klientin dhe rritjen e eficiencës tregtare. Aktiviteti synoi forcimin e aftësive menaxheriale dhe mbështetjen e objektivave strategjike të institucionit në fushën e shitjeve.

MIRËQENIA E PUNONJËSVE DHE KULTURA ORGANIZATIVE

Në vijim të angazhimit të MiA Finance për promovimin e një mjedisi pune pozitiv dhe mbështetjen e ekuilibrit ndërmjet jetës





Workshop-i “Shitjet Efektive”, prill 2025.

profesionale dhe asaj personale, gjatë vitit 2025 u zbatua për të dytin vit radhazi iniciativa “Të Premtet Verore”.

Kjo nismë u zhvillua përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2025 dhe parashikoi reduktimin e orarit të punës çdo të premte, me përfundimin e ditës së punës në orën 14:30. Programi synoi të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së punonjësve, forcimin e motivimit dhe përmirësimin e balancës ndërmjet angazhimeve profesionale dhe jetës personale.

Vazhdimësia e kësaj iniciative për të dytin vit radhazi pasqyron përkushtimin e institucionit ndaj praktikave moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe krijimit të një kulture organizative që vlerëson dhe mbështet punonjësit e saj.

PËRMIRËSIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE

Në fund të vitit 2025, MiA Finance ndërmori një proces rishikimi dhe përmirësimi të strukturës organizative, me qëllim rritjen e eficiencës operacionale, përmirësimin e koordinimit ndërmjet njësive organizative dhe mbështetjen e objektivave strategjike të institucionit.

Ndryshimet e ndërmarra synuan optimizimin e proceseve të punës, qartësimin e roleve dhe përgjegjësive, si dhe forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe operacionale. Struktura e re organizative u hartua në përputhje me zhvillimin e aktivitetit të institucionit dhe nevojën për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive kërkesave të tregut dhe sfidave të sektorit financiar.

Këto përmirësime pritet të kontribuojnë në rritjen e performancës së përgjithshme të institucionit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve dhe forcimin e mëtejshëm të standardeve të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm.

UniFin SHKK

3 vite

radhazi pa asnjë fshirje kredie

ECURIA E PËRGJITHSHME E VEPRIMTARISË DHE INDIKATORËT KRYESORË

Viti 2025 përfaqësoi një tjetër vit konsolidimi dhe zhvillimi për SHKK UniFin, duke konfirmuar qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe aftësinë e tij për të mbështetur anëtarët në një mjedis ekonomik të favorshëm. Gjatë gjithë vitit, UniFin zhvilloi aktivitetin e saj në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke ruajtur standarde të larta të qeverisjes, transparencës dhe administrimit të riskut. Treguesit financiarë dhe operacionalë reflektuan një rritje të qëndrueshme, efikasitet në menaxhim dhe përmirësim të qëndrueshmërisë institucionale.

Totali i aktiveve arriti në **1.64 miliardë lekë,** duke reflektuar një rritje prej **7.12%** në krahasim me fundin e vitit 2024.

Kapitali i Shoqatës u rrit me **9.9%**, duke rritur fuqinë financiare dhe kapacitetin për financim të mëtejshëm.

Portofoli i kredisë bruto u zgjerua ndjeshëm, duke arritur në **1.547 miliardë lekë,** me një rritje vjetore prej **9.2%.**

Depozitat e anëtarëve u rritën në **1.315 miliardë lekë,** me një ritëm prej **6%**, si rezultat i fushatave të mirëorganizuara për thithjen e fondeve dhe besimit në shërbimet e SHKK-së.

Anëtarësia arriti në **22,526 persona,** me **726 anëtarë të rinj,** duke konfirmuar besueshmërinë e SHKK-së në komunitet.

Risku i kredisë (NPL): Ruajtja e cilësisë së portofolit të kredisë. Pavarësisht rritjes së aktivitetit kreditues, raporti i kredive me probleme u mbajt në nivelin rreth 2.6%, ndër më të ulëtit në sektor, ndërsa viti 2025 shënoi vitin e tretë radhazi pa asnjë fshirje kredie. Kjo dëshmon efektivitetin e politikave të kreditimit, monitorimit dhe administrimit të riskut të ndjekura nga institucioni.

Këta tregues jo vetëm që konfirmojnë rritjen, por tregojnë për një **menaxhim të kujdesshëm dhe afatgjatë** të burimeve financiare dhe rreziqeve të lidhura me aktivitetin e SHKK-së.

ZHVILLIME DHE RISI NE SHERBIMET / PRODUKTET E OFRUARA DHE MODELIN E BIZNESIT

Gjatë vitit 2025, SHKK UNIFIN ka vijuar angazhimin e saj në përmirësimin e ofertës së produkteve financiare, me synimin për të qenë sa më pranë nevojave reale të anëtarëve dhe për të ruajtur konkurrueshmërinë në treg.

- Gjatë vitit 2025 u rishikuan kushtet e produkteve të kredisë, duke përfshirë normat e interesit, komisionet dhe kriteret e garancive. Ndryshimet u orientuan drejt lehtësimit të aksesit në financim, veçanërisht për anëtarët besnikë dhe përseritës, nëpërmjet përafrimit të kërkesave për garanci me praktikat më të mira të tregut. Këto masa synuan rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve të UniFin, përmirësimin e eksperiencës së anëtarëve dhe ofrimin e një trajtimi më të favorshëm për klientët me histori të mirë bashkëpunimi me institucionin.
- Gjatë vitit 2025, UniFin ndërmori hapa për të forcuar komunikimin institucional dhe promovimin e produkteve e shërbimeve të saj, duke krijuar bazat për një qasje më të strukturuar të marketingut, në mbështetje të objektivave të zhvillimit të institucionit.
- Në kuadër të strategjisë për zgjerimin e pranisë së institucionit dhe përmirësimin e aksesit të anëtarëve në shërbimet financiare, gjatë vitit 2025, SHKK UniFin hapi degën e saj të dytë në qytetin e Korçës, Korça 2. Hapja e kësaj dege përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e pranisë së UniFin në rajon dhe në ofrimin e shërbimeve më pranë anëtarëve dhe komunitetit lokal.
- SHKK UniFin realizoi një sërë investimesh të rëndësishme në forcimin e sigurisë kibernetike dhe modernizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, me qëllim rritjen e mbrojtjes së sistemeve, të dhënave dhe shërbimeve të institucionit. Në këtë kuadër, u implementuan zgjidhje të avancuara të sigurisë, përfshirë segmentimin e rrjetit të brendshëm (VLAN), instalimin e një firewall-i të gjeneratës së re (Next Generation Firewall), si dhe zëvendësimin e pajisjeve fundore me pajisje më moderne dhe më të sigurta. Këto investime kanë forcuar ndjeshëm nivelin e mbrojtjes ndaj kërcënimeve kibernetike, kanë reduktuar riskun operacional dhe kanë krijuar një infrastrukturë teknologjike më të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të SHKK UniFin.
- Gjatë vitit 2025, UniFin vijoi të investojë në zhvillimin profesional të stafit përmes pjesëmarrjes në trajnime, aktivitete zhvillimore dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Këto iniciativa synuan forcimin e kompetencave profesionale, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj anëtarëve dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të institucionit.
- Paralelisht me zhvillimin e aktivitetit të brendshëm, UniFin vijoi të jetë pjesëmarrëse aktive në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të mikrofinancës, duke marrë pjesë në aktivitetet e Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës, European Microfinance Network dhe forume të tjera rajonale. Këto angazhime mundësuan shkëmbimin e eksperiencave, njohjen me praktikat më të mira evropiane dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim institucional.

Sfidat dhe strategjia për vitin 2026

Një nga sfidat kryesore strategjike të SHKK UniFin në vitin 2026 do të ketë si fidën e tij kryesore dhe të rëndësishme strategjike për sektorin e Shoqërive të Kursim Kreditit, atë që është e me **procesin e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.** UniFin do të angazhohet aktivisht në mbrojtjen e modelit të Shoqërive të Kursim Kreditit, duke kontribuar në dialogun institucional për krijimin e një kuadri ligjor që garanton zhvillimin e qendrueshëm të sektorit.

Rritje e mëtejshme e portofolit të kredive në nivelin **1.9 miliard lekë**, duke ruajtur cilësinë e huave.

Zbatimin e një strategjie afatmesme për digjitalizimin e shërbimeve dhe produkteve – hap drejt modernizimit dhe automatizimit të proceseve.

Zgjerimi i gamës se produkteve, për të përfshirë shërbime të reja për anëtarët përtej kredive dhe depozitave – me synim **diversifikimin e të ardhurave dhe rritjen e bazës së klienteve**.





Hapja e degës Korça 2 dhe aktivitete të UniFin gjatë 2025.



Përmbledhje e aktiviteteve të Shoqatës gjatë vitit 2025

GJYSMA E PARË

Dialog institucional dhe zhvillim i sektorit

Dialog me anëtarët, Bankën e Shqipërisë dhe partnerët mbi zhvillimet rregullatore, digjitalizimin dhe AML.

GJYSMA E DYTË

Financimi i gjelbër, bujqësia, transformimi digjital

Diskutime mbi financimin e gjelbër, eficiencën e energjisë dhe teknologjitë inovative në bujqësi.

RAJONALE

MicroBalkans25, Dubrovnik

Përfshirja financiare dhe roli i mikrofinancës për familjet me të ardhura të ulëta.

NËNTOR

Pagesat digjitale dhe siguria kibernetike

Workshop AMA–AMIK me mbështetjen e IFC në Prizren; “The Future of Cybersecurity in the Financial Sector”.

DHJETOR

Përfaqësimi ndërkombëtar

Konferenca “Microcredit: An Instrument of Social Cohesion”, Jean Monnet Module — MAISCO-EU/Erasmus+.

09

Përmbledhje e aktiviteteve të Shoqatës gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) vijoi të konsolidojë rolin e saj si zëri përfaqësues i sektorit të mikrofinancës, duke u fokusuar në dialogun institucional dhe rregullator, zhvillimin e kapaciteteve, transformimin digjital, financimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar.

GJYSMA E PARË E VITIT – DIALOG INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIM I SEKTORIT

AMA zhvilloi një dialog të vazhdueshëm me institucionet anëtare, Bankën e Shqipërisë dhe partnerët vendas e ndërkombëtarë mbi zhvillimet rregullatore dhe çështjet me rëndësi për sektorin. Vëmendje e veçantë iu kushtua digjitalizimit, kuadrit rregullator, çështjeve të AML-së dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mikrofinancës.

Gjysma e dytë e vitit – Financimi i gjelbër, bujqësia dhe transformimi digjital

AMA kontribuoi në diskutime mbi financimin e gjelbër, eficiencën e energjisë dhe investimet e qëndrueshme, si dhe mbi financimin e teknologjive inovative në bujqësi. Në këto aktivitete u prezantua perspektiva e sektorit të mikrofinancës për përmirësimin e aksesit në financim të fermerëve dhe komuniteteve rurale, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, sektorit financiar dhe partnerëve të zhvillimit.

Në planin rajonal, AMA mori pjesë në MicroBalkans25 në Dubrovnik, duke kontribuar në diskutimet mbi përfshirjen financiare, eficiencën e energjisë dhe rolin e mikrofinancës në mbështetjen e familjeve me të ardhura të ulëta dhe komuniteteve më vulnerabël.





MicroBalkans25, Dubrovnik.

NËNTOR – PAGESAT DIGJITALE, KONKURRENCA DHE SIGURIA KIBERNETIKE

Në nëntor, AMA dhe Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK), me mbështetjen e IFC-së, organizuan në Prizren workshop-in e përbashkët "Innovations in Cashless Payments: Opportunities for the Microfinance Sector". Aktiviteti trajtoi zhvillimet në pagesat digjitale, modelet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve mikrofinanciare, bankave, PSP-ve dhe fintech-eve, përdorimin e të dhënave të transaksioneve për vlerësimin e kreditit dhe integrimin e pagesave cashless në ciklin e biznesit të mikrofinancës.

AMA mori gjithashtu pjesë në aktivitetin mbi përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës, ku u diskutua roli i shoqatave të biznesit në promovimin e konkurrencës së ndershme, integritetit institucional dhe standardeve të tregut.

Siguria kibernetike ishte një tjetër fushë e rëndësishme e angazhimit. AMA u përfaqësua në aktivitetin e organizuar nga IFC dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, "The Future of Cybersecurity in the Financial Sector", duke kontribuar në diskutimet mbi menaxhimin e incidenteve kibernetike, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimin ndërmjet industrisë financiare dhe autoriteteve.

DHJETOR – PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR I MIKROFINANCËS SHQIPTARE

AMA e përmbylli vitin me pjesëmarrjen në konferencën ndërkombëtare "Microcredit: An Instrument of Social Cohesion", zhvilluar në kuadër të programit Jean Monnet Module – MAISCO-EU/Erasmus+.

Në këtë aktivitet u evidentua roli i mikrofinancës shqiptare si një instrument për fuqizimin ekonomik, inovacionin dhe përfshirjen sociale, si dhe kontributi i sektorit në digjitalizim, zhvillimin e komuniteteve dhe mbështetjen e sipërmarrjeve të vogla, përfshirë bizneset e drejtuara nga gratë.

PËRMBLEDHJE

Viti 2025 shënoi një zgjerim të mëtejshëm të rolit të AMA-s, nga përfaqësimi tradicional i interesave të institucioneve anëtare drejt një roli më aktiv si platformë dialogu, bashkëpunimi dhe zhvillimi për sektorin e mikrofinancës.

Përmes bashkëpunimit me institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat homologe në rajon, AMA avancoi tema me rëndësi strategjike për sektorin, si transformimi digjital, financimi i gjelbër, siguria kibernetike, financimi i bujqësisë dhe përfshirja financiare, duke forcuar njëkohësisht përfaqësimin e mikrofinancës shqiptare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

09

Përmbledhje e aktiviteteve të Shoqatës gjatë vitit 2025

Prioritetet e institucioneve anëtare për 2026

Agro & Social Fund

- Konsolidimi i logos dhe i identitetit të ri vizual
- Monitorimi i vazhdueshëm i tregut dhe rishikimi i produkteve
- Pjesëmarrje aktive në konferenca dhe takime profesionale

Crimson Finance Fund Albania

- Hapja e një dege të re në një qytet tjetër
- Aplikacion mobile i dedikuar në Google Play dhe App Store
- Rritja e mëtejshme e impaktit social të huave

FED invest

- Rritja e anëtarësisë
- Zgjerimi i financës së gjelbër dhe iniciativave ESG
- Investime në transformimin digjital dhe sigurinë kibernetike

Fondi Besa (2026–2028)

- Zgjerimi i aksesit financiar në zonat me përfshirje më të ulët
- Thellimi i transformimit digjital dhe automatizimit
- Diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve financiare

ECFA · Kredo.al

- Lançimi i aplikacionit mobile Kredo.al
- Inteligjenca Artificiale për analiza më të sakta të riskut
- Forcimi i sigurisë kibernetike (DLP, Zero Trust)

MiA Finance

- Zhvillim i qëndrueshëm i aktivitetit kredidhënës
- Menaxhim i riskut dhe ruajtje e cilësisë së portofolit
- Zgjerim i përfshirjes financiare

UniFin SHKK

- Harmonizimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian
- Rritja e portofolit të kredive në 1.9 miliardë lekë
- Strategji afatmesme për digjitalizimin e shërbimeve

iute Albania

[MUNGON] PRIORITETET PËR 2026 NUK JANË TË PËRCAKTUARA NË MATERIALIN E DORËZUAR

"Shoqata Mikrofinanca Shqiptare do të vijojë të promovojë një sektor mikrofinanciar modern, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit."

ARLINDA MUJA, PRESIDENT

SHTOJCË

Shkurtesat

AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AKSK	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
AMA	Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (Albanian Microfinance Association)
AMIK	Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
AML/CFT	Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit
BERZH / EBRD	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BNPL	"Bli tani, paguaj më vonë" (Buy Now, Pay Later)
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës
DTI	Raporti kredi / të ardhura (Debt-to-Income)
EMN	European Microfinance Network
ESG	Kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes
IFC	International Finance Corporation
IFJB	Institucione financiare jobanka
MFC	Microfinance Centre
NPL	Kredi me probleme (Non-Performing Loans)
NVM / SME	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
PAR 90+	Portofoli në rrezik mbi 90 ditë
ROA	Kthimi mesatar nga aktivet
ROE	Kthimi mesatar nga kapitali
SFJB	Subjekte financiare jobanka
SHKK	Shoqëri të kursim-kreditit
USHKK	Unioni Shqiptar i Kursim-Kreditit


Shoqata
Mikrofinanca
Shqiptare
Albanian
Microfinance
Association